



**GRATË NË ISLAM
KUNDREJT
GRAVE NË TRADITËN JUDEO-KRISTIANE**

MITI & REALITETI

Nga:

Dr. Sherif Abdel Azim

Shqipëroi: Edin Q. Lohja

Me Emrin e Zotit - Gjithëmëshiruesit, të Plotmëshirshmit

1. Hyrje

Pesë vjet më parë, në numrin e *Toronto Star* të 3 Korrikut 1990, lexova një artikull të titulluar “Islami s’është i vetëm në doktrinat patriarkale”, nga Gwynne Dyer. Artikulli përshkruante reagimet e tërbuara nga pjesëmarrëset e një konference mbi gratë dhe pushtetin, të mbajtur në Montreal, ndaj komenteve të feministes së njohur egjyptiane Dr. Nawal Sādawi. Pohimet e saj politikisht jokorrekte përfshinin: “elementet më shtrënguese dhe kufizuese ndaj grave mund të gjehen së pari në Judaizëm në Dhiatën e Vjetër, pastaj në Kristianizëm dhe më pas në Kur’an”; “të gjitha fetë janë patriarkale sepse burojnë nga shoqëri patriarkale”, dhe “mbulimi i grave nuk është një praktikë ekskluzivisht islame, por një trashëgim i lashtë kulturor me ngjashmëri në fetë simotra.” Pjesëmarrësit s’mund të duronin të qëndronin ndenjur ndërkohë që besimet e tyre po barazoheshin me Islamin. Kështu, Dr. Sādawi korri një stuhi kritikash. “Komentet e Dr. Sādawi-t janë të papranueshme. Përgjigjet e saj zbulojnë një mungesë të të kuptuarit të besimeve të popujve të tjerë”, deklaroi Bernice Dubois e Lëvizjes Botërore të Nënave. “Unë duhet të protestoj” - tha panelistja e rjetit izraelit të grave, “nuk ka koncept të mbulesës në Judaizëm.” Artikulli ia atribuonte këto protesta të egërsuara prirjes në Perëndim për ta bërë Islamin *çjapin e shushavës**[*Shprehje për atë që fajësohet dhe dënohet për mëkatet e të tjerëve; në Dhiatën e Vjetër, çjap tek i cili përcilleshin ceremonialisht mëkatet e çifutëve e i cili pastaj përzihet (sh.p.) për praktika që janë në po atë masë pjesë e trashëgimisë kulturore të vetë Perëndimit. “Feministet kristiane dhe çifute nuk do rrinin të ulura duarlidhur ndërkohë që diskutoheshin në një kategori të njëjtë me ata muslimanët e ligë”, shkruan Gwynne Dyer.

Nuk u çudita që pjesëmarrësit e konferencës kishin mbajtur një këndvështrim kaq negativ, sidomos kur ishte fjala për çështjet e grave. Në Perëndim, Islami besohet të jetë simboli i nënshtrimit të grave *par excellence*. Për të kuptuar sa e shëndoshë është kjo bindje, mjafton të përmendim që Ministri i Arsimit në Francë, tokën e Voltaire-it, ka urdhëruar kohët e fundit përjashtimin e të gjitha të rejave muslimane që veshin mbulesë, nga shkollat franceze!¹ Një së reje muslimane që vesh një shami koke i mohohet e drejta e saj për arsimim në Francë, ndërsa një studenteje katolike që mban një kryq apo një studenti çifut që vesh një *jarmulke*, [kapele karakteristike e meshkujve çifutë në formë rrethi që mbulon një pjesë të syprinës së kokës – sh.p] jo. Skena e policeve franceze që pengonin vajzat muslimane që vishnin shami mbi kokë nga të hyrit në shkollën e tyre të mesme, është e paharrueshme. Ajo frymëzon kujtimet e një skene po aq të pahijshme të Guvernatorit George Wallace të Alabamas më 1962 i cili qëndronte përpara derës së shkollës, në përpjekje për të bllokuar hyrjen e studentëve të zinj me qëllim ndalimin e desegregimit në shkollat e Alabamas. Ndryshimi ndërmjet këtyre dy skenave është se studentët zezakë kishin simpatinë* (*Ndjenjën e bashkëvuajtjes, dhembshurinë - sh.p.) e aq shumë njerëzve në Shtetet e Bashkuara dhe në mbarë botën. Presidenti Kennedy dërgoi Gardën Kombëtare të Shteteve të Bashkuara për të mundësuar me forcë hyrjen e studentëve me ngjyrë. Vajzat muslimane, nga ana tjetër, s’morrën asnjëlloj ndihme nga askush. Çështja e tyre dukej se kishte shumë pak simpati si brenda, ashtu edhe jashtë Francës. Arsyeja ishte keqkuptimi i shumëpërhapur dhe frika nga çdogjë islame në botë sot.

Ajo që më ngacmoi më shumë për konferencën e Montrealit ishte një pyetje: *A ishin pohimet e bëra nga Sadawi, apo cilado prej kritikuesve të saj, faktuale? Me fjalë të tjera, a kanë Judaizmi, Krishterimi dhe Islami të njëjtin koncept për gratë? A i ofrojnë Judaizmi dhe Krishterimi grave një trajtim me të vërtetë më të mirë se Islami? Cila është e vërteta?*

Nuk është e lehtë të kërkosh e të gjesh përgjigje për këto pyetje të vështira. Vështirësia e parë qëndron në atë se duhet të jesh i ndershëm, i paanshëm dhe objektiv, ose të paktën të bësh çdo gjë që ke në dorë për të qenë i tillë. Kjo është ajo që mëson Islami. Kur'ani i ka udhëzuar muslimanët të thojnë të vërtetën edhe në qoftë se atyre që u janë të afërt s'i pëlqen: **“Kurdoherë që të flitni (dëshmoni), flitni drejt, edhe nëse është çështja për të afërmit...”** (6:152); **“O’ ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë (për hir) të Allahut, edhe nëse është kundër jush, kundër prindërve ose të afërmeve tuaj, qoftë (kundër) pasanikut, apo të varfrit.”** (4:135)

Vështirësia tjetër e madhe është gjerësia e pakapërcyeshme e temës. Prandaj, gjatë këtyre pesë viteve të fundit, kam kaluar shumë orë duke lexuar Biblën, Enciklopedinë e Fesë dhe Enciklopedinë Judaikë, në kërkim të përgjigjeve. Kam lexuar gjithashtu mjaft libra që diskutojnë pozicionin e grave në fetë e ndryshme, të shkruar nga shumë studiues, apologjetë dhe kritikë. Materiali i paraqitur në kaptinat vijuese përfaqëson gjetjet e rëndësishme të këtij kërkimi modest. Unë nuk pretendoj të jem absolutisht objektiv. Kjo është përtej mundësive të mia të kufizuara. E gjitha ç'mund të them është se jam përpjekur, përgjatë gjithë këtij hulumtimi, t'i afrohem idealit kur'anor të “të folurit drejt.”

Para se të fillojmë, do të doja të theksoj në këtë hyrje se qëllimi im nuk është që nëpërmjet këtij prezantimi të përçmoj Judaizmin apo Krishterimin. Si muslimanë, ne besojmë në prejardhjen hyjnore të të dyjave. Asnjëri s'mund të jetë musliman pa besuar në Moisiun dhe Jezusin (paqja qoftë mbi ta) si profetë të mëdhenj të Zotit. Qëllimi im i vetëm është të rivlerësoj Islamin dhe të nderoj - çka përbën një borxh të harruar në Perëndim - Mesazhin e vërtetë përfundimtar nga Zoti për racën njerëzore. Desha gjithashtu të theksoj se jam marrë vetëm me *doktrinën*. Pra, në qendër të vëmendjes sime është kryesisht pozicioni i grave në të trija fetë ashtu siç paraqitet në burimet e tyre origjinale e jo siç praktikohet nga milionat e ndjekësve të tyre sot në botë. Prandaj, shumica e fakteve të cituara vjen nga Kur'ani, thëniet e profetit Muhammed (s), Bibla, Talmudi dhe thëniet e disa prej Etrëve kishtarë më ndikues, pikëpamjet e të cilëve kanë kontribuar pamasë në përkufizimin dhe formësimin e Krishterimit. Ky interesim për burimet lidhet me faktin se të kuptuarit e një feje të caktuar nga qëndrimet dhe sjellja e disa prej ndjekësve të saj në emër, është çorientuese. Shumë njerëz ngatërrojnë kulturën me fenë, shumë të tjerë nuk dinë se ç'thonë librat e tyre të fesë, e akoma më shumë as që e çajnë kokën.

2. FAJI I EVËS ?

Të trija fetë puqen në një fakt themelor: Si burrat, ashtu edhe gratë janë krijuar nga Zoti, Krijuesi i të gjithë universit. Megjithatë, mospajtimi fillon menjëherë pas krijimit të burrit të parë Adamit dhe gruas së parë, Evës. Koncepti judeo-kristian i krijimit të Adamit dhe Evës është përshkruar hollësisht tek Zanafilla 2:4 - 3:24. “Zoti ua ndaloi të dyve ngrënien e frutave nga pema e ndaluar. Gjarpri e joshi Evën të hante nga ajo dhe Eva pastaj joshi Adamin të hante me të. Kur Zoti e qortoi Adamin për atë që bëri, ky ia hodhi gjithë fajin Evës: **‘Gruaja që ke vendosur këtu me mua, ajo më dha frut nga pema dhe unë hëngra.’** Si pasojë Zoti i tha Evës:

‘Unë do të t’i shtoj së tepërmi dhimbjet e tuaja në shtatzani: në dhimbje të mëdha do lindësh fëmijë. Dëshira jote do të jetë për burrin tënd dhe ai do sundojë mbi ty.’

Ndërsa Adamit Ai i tha:

‘Ngaqë dëgjove gruan tënde dhe hëngre prej asaj peme... e mallkuar është toka për shkakun tënd: përmes punësh të rënda do hash prej saj të gjitha ditët e jetës tënde.’” (Gjeneza 3:12-17)

Koncepti islam i Krijimit të parë gjehet në disa vende në Kur’an, p.sh.:

“(Ne i thamë) **O’ Adem, ti dhe bashkëshortja jote zini vend në Xhennet, hani nga të doni por mos iu afroni kësaj peme, sepse do të bëheni prej vetëdëmtuesve dhe shkelësve.** (Pastaj) shejtani u pëshpëriti të dyve që t’ua zbulojë atyre pjesët e turpshme që ishin të mbuluara dhe tha: **‘Zoti juaj jua ndaloi ju të dyve këtë pemë vetëm që të mos bëheni ëngjëj, ose prej të përjetshmëve.’** Dhe iu betua atyre se ishte këshilluesi i tyre i sinqertë. Atëherë me mashtrim i zbriti (në nivel të palakmueshëm). E kur e shijuan pemën, vendturpi i tyre u zbulua dhe ata filluan ta mbulojnë atë me gjethet e xhennetit. Zoti i tyre u thirri: **‘A nuk jua ndalova ju dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë të dyve se shejtani është armik i hapët për ju?’** Ata thanë: **‘Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetes sonë, e në qoftë se ti nuk na mbulon (mëkatit) dhe nuk na mëshiron, ne mesiguri do të jemi prej të shkatërruarve.’**” (7:19-25)

Një vështrim i kujdesshëm mbi dy përshkrimet e rrëfimit të Krijimit zbulon disa ndryshime thelbësore. Kur’ani, në kontrast me Biblën, i vë faj të njëlojtë Adamit dhe Evës për gabimin e tyre. Askund në Kur’an s’mund të gjehet as edhe shenja më e vogël se Eva e joshi Adamin të hajë nga pema e madje as që ajo kish ngrënë para tij. Eva në Kur’an s’është as joshëse, as tunduese e as mashtruese. Përveç kësaj, Eva nuk fajësohet për dhimbjet e shtatzanisë. Zoti, sipas Kur’anit, nuk dënon askënd për fajet e një tjetri. Të dy, Adami dhe Eva kryen një mëkat e pastaj iu lutën Zotit për falje dhe Ai i fali që të dy.

3. TRASHËGUESËT E EVËS ?

Imazhi i Evës si joshëse dhënë në Bibël, ka shkaktuar një ndikim skajimisht negativ përgjatë gjithë traditës judeo-kristiane. Të gjitha gratë mendohej të kishin trashëguar nga nëna e tyre, Eva e Biblës, si fajin ashtu edhe dinakërinë e saj. Si pasojë, ato të gjitha s'ishin të denja t'u besohej, moralisht inferiore dhe të poshtra. Menstruacioni, shtatzania dhe rritja e fëmijës konsideroheshin ndëshkimi i merituar për fajin e përjetshëm të seksit femëror të mallkuar. Për të kuptuar sa negativ ishte ndikimi i Evës së Biblës në të gjitha pasardhëset e saja, duhet t'u hedhim një sy shkrimeve të disa prej çifutëve dhe kristianëve më të rëndësishëm të të gjitha kohërave. Le të fillojmë me Dhiatën e Vjetër dhe të shikojmë pjesë nga ajo që quhet Libri i Mençurisë, në të cilën gjejmë:

“Mua më duket më e hidhur se vdekja gruaja, që është një grackë, zemra e së cilës është një rrjetë dhe duart e së cilës janë zinxhirë. Burri që kënaq Zotin do i ikë asaj, por mëkatarin ajo do e zërë në grackë... Tek po kërkoja dhe ende nuk po gjej, pashë një burrë të ndershëm në mes njëmijëve, por as edhe një grua të ndershme midis të gjithave.” (Eklestastiku 7:26-28)

Duhet të pyetet se: ku qëndron mençuria në të mohuarit e ekzistencës së as edhe një gruaje të ndershme mbi tokë? Në një pjesë tjetër të literaturës hebreje që ndodhet në Biblën Katolike lexojmë:

“Asnjë poshtërsi s'i afrohet askund poshtërsisë së një gruaje... Mëkati filloi me gruan dhe falë saj të gjithë duhet të vdesim.” (Eklestastiku 25:19, 24)

Rabinët çifutë numëruan nëntë mallkime të rëna mbi gratë si rrjedhojë e Rënies:

“Gruas Ai i dha nëntë mallkime dhe vdekjen: barrën e gjakut të menstruacionit dhe gjakun e virgjërisë; barrën e shtatzanisë; barrën e lindjes; barrën e rritjes së fëmijëve; koka e saj është e mbuluar si e atij që mban zi; ajo e shpon veshin e saj si një skllav i përjetshëm apo një robinë që i shërben pronarit; asaj nuk i duhet besuar si dëshmitare; dhe pas të gjithave - vdekja.”¹

Edhe sot e kësaj dite burrat ortodoksë çifutë në lutjen e tyre të përditshme të mëngjesit recitojnë: **“Lavdi Zotit që s'më ka bërë grua.”** Gratë, nga ana tjetër, falenderojnë Zotin çdo mëngjes që **“më ke bërë sipas vullnetit Tënd.”**² Një lutje tjetër që gjendet në shumë libra çifute lutjesh është: **“I lavdëruar (qoftë) Zoti që s'më ka krijuar të sjellshëm. I lavdëruar qoftë Zoti që s'më ka krijuar grua. I lavdëruar qoftë Zoti që nuk më ka krijuar të paditur.”**⁴

Eva Biblike ka luajtur një rol shumë më të madh në Kristianizëm se në Judaizëm. Mëkati i saj ka qenë themelvënës për tërë besimin e krishterë sepse koncepti kristian i arsyes së misionit të Jezu Krishtit në Tokë buron nga mosbindja e Evës ndaj Zotit. Ajo kishte mëkatur dhe pastaj joshur Adamin për të ndjekur teken e saj. Si rrjedhim, Zoti i përzuri të dy nga Parajsa për në Tokë, e cila ishte mallkuar për shkak të tyre. Ata ia përcollën mëkatin e tyre, që nuk ishte falur nga Zoti, të gjithë pasardhësve të tyre dhe kështu, të gjithë njerëzit janë të lindur me mëkat. Për të pastruar të gjitha qeniet njerëzore nga 'mëkati fillestar' i tyre, Zotit iu desh të flijonte Jezusin, që mbahet të jetë Biri i Zotit, në kryq. Ndaj, Eva është përgjegjëse për gabimin e vet, mëkatin e të shoqit, mëkatin fillestar të tërë njerëzimit si dhe

vdekjen e Birit të Zotit. Me fjalë të tjera, një grua që veproi sipas kokës së vet shkaktoi rënien e tërë njerëzimit.⁵ Po vajzat e saja? Ato janë mëkatore si ajo dhe duhen trajtuar si të tilla. Dëgjojeni tonin e ashpër të Shën Palit në Dhiatën e Re:

“Një grua duhet të mësojë në heshtje dhe nënshtrim të plotë. Unë s’i lejoj një gruaje të japë mësim apo të ketë autoritet mbi një burrë; ajo duhet të heshtë. Sepse Adami u krijua i pari e pastaj Eva. Dhe s’ish Adami që u mashtrua - ishte gruaja që u gënjye dhe u bë mëkatore.” (I Timoteut 2:11-14)

Shën Tertuliani ishte edhe më mizor se Shën Pali, kur u fliste ‘motrave të tija më të dashura’ në fe:

“A nuk e dini ju që secila jeni një Evë? Dënimi i Zotit për këtë gjini tuajën jeton edhe sot: faji duhet medoemos të jetojë gjithashtu. Ju jeni porta e djallit; ju jeni zbulueset e pemës së ndaluar; ju jeni tradhëtuesi i parë i ligjit hyjnor; ju jeni ajo që bindët atë të cilin djalli s’që aq trim sa ta sulmonte. Ju shkatërruat aq lehtësisht imazhin e Zotit - njeriun. Për shkak të shkeljes suaj madje edhe birit të Zotit iu desh të vdiste.”⁶

Shën Agustini i qëndroi besnik traditës së paraardhësve të tij; ai i shkruante një mikut të vet:

“Ç’ndryshim ka nëse është në një bashkëshorte apo një nënë, prapëseprapë mbetet Eva tunduesja që duhet të mbajmë parasysh në çdo grua... Unë s’arrij të shoh se e ç’dobie mund t’i jetë gruaja një burri, nëse përjashtohet funksioni i mbartjes së fëmijëve.”

Shekuj më vonë, Shën Tomas Akuini akoma i konsideronte gratë të meta:

“Përsaipërket natyrës vetjake, gruaja është defektive (e metë), e pandershme dhe e planifikuar keq, sepse forca aktive në farën e mashkullit anon nga prodhimi i një ngjashmërie të përkryer me seksin mashkullor, ndërkohë që prodhimi i gruas vjen nga një defekt në forcën aktive ose nga ndonjë sëmundje [çregullim a mospërshtatje] e lehtë materiale apo madje nga ndonjë ndikim i jashtëm.”

Së fundi, reformatori i shquar Martin Luther s’mund të shihte asnjë dobi nga gruaja përveç të sjellurit në botë të sa më shumë fëmijëve që të jetë e mundur, pavarësisht nga pasojat anësore:

“Nëse lodhen apo edhe vdesin, kjo s’ka rëndësi. Lërimi të vdesin gjatë lindjes, ja përse ato ekzistojnë në rradhë të parë.”

Përsëri dhe vazhdimisht të gjitha gratë tallen deri në poshtërim për shkak të imazhit të Evës joshëse e kjo falë përshkrimit të Zanafillës. Për ta përmbledhur, koncepti judeo-kristian i grave është helmuar nga besimi në natyrën e mëkatit të Evës dhe pasardhësve të saja.

Nëse tani e kthejmë vëmendjen nga ajo që Kur'ani ka për të thënë mbi gratë, do të kuptojmë shpejt që koncepti islam i grave është rrënjësisht i ndryshëm nga ai i traditës judeo-kristiane. Le të flasi vetë Kur'ani:

“(Nuk ka dyshim se) për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët dhe besimtares, të devotshmit dhe të devotshmet, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët dhe durimtares, të përulurit dhe të përulurat (ata që i falen Zotit), lëmoshëdhënësit dhe lëmoshëdhënëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit dhe ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit dhe shumëpërmendëset e Allahut - (për të gjithë ata) Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (33:35)

“Besimtarët, burrat dhe gratë, janë mbrojtës të njëri-tjetrit: ata urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë çka është e keqe; ata kujdesen për (kryejnë) faljet rregullisht, bëjnë bamirësi rregullisht dhe i binden Allahut e të Dërguarit të Tij. Mbi ta, Allahu do të zbresë mëshirën e Tij; sepse Allahu është i Lartësuar në fuqi, i Urtë.” (9:71)

“Dhe Zoti i tyre iu përgjigj atyre: me të vërtetë Unë nuk do lejoj të humbasin veprat e asnjërit prej jush, qoftë femër apo mashkull, ju jeni (pjesë e) të njëri-tjetrit.” (3:195)

“Kushdo që bën një vepër të keqe ndëshkohet për aq sa është ajo (e keqe), e kush bën një vepër të mirë - qoftë mashkull apo femër, dhe është besimtar/e - të tillët hyjnë në Xhennet dhe aty shpërblehen pa masë.” (40:40)

“Kushdo që bën mirësi - qoftë mashkull a femër, dhe është besimtar/e - Ne do t'u japim një jetë që është aq e mirë dhe e pastër (në këtë botë) e do t'u dhurojmë shpërblimin më të mirë (në atë botë) për veprat e tyre.” (16:97)

Është e qartë se vështrimi kur'anor për gratë nuk ndryshon nga ai për burrat. Ata, që të dy, janë krijesa të Zotit, qëllimi sublim i të cilëve në tokë është të adhurojnë Zotin e tyre, të bëjnë vepra të mira duke shmangur të keqen dhe ata, që të dy, do vlerësohen në lidhje me to. Kur'ani kurrë nuk përmend se gruaja është 'porta e djallit', apo që është 'mashtuese për nga natyra'. Kur'ani gjithashtu, asnjëherë nuk përmend se njeriu është shëmbëlltyra e Zotit; tërë burrat dhe gratë janë krijesa të Tij, kjo është e gjitha. Sipas Kur'anit, roli i një gruaje mbi tokë nuk kufizohet vetëm në të lindurit e fëmijëve. Ajo është e detyruar të bëjë po aq vepra të mira sa ç'është i detyruar cilido burrë. Kur'ani s'thotë kurrë që nuk ka ekzistuar ndonjëherë asnjë grua e ndershme. Përkundrazi, Kur'ani i ka udhëzuar të gjithë besimtarët, si gratë ashtu dhe burrat, të ndjekin shembullin e atyre grave si Virgjëresha Marie dhe gruaja e Faraonit:

“Dha Allahu shpalos, si shembull për ata që besojnë, gruan e Faraonit kur ajo tha: 'O Zoti im, ngrit për mua pranë Teje, një vilë të madhe në Xhennet, dhe më çliro nga faraoni dhe veprimet e tij, dhe shpëtomë nga ata që bëjnë gabim.' Dhe Maria e bija e Imranit, që ruajti nderin e saj e Ne frymë në trupin e saj nga Shpirti Ynë; dhe

ajo dëshmoi të vërtetën e fjalëve të Zotit të saj dhe të shpalljeve të Tija e u bë nga më të devotshmet.” (66:11-13)

4. BIJAT TURPËRUESE ?

Ç'është e vërteta, ndryshimi ndërmjet qëndrimit kur'anor dhe biblik ndaj gjinisë femërore fillon porsa një femër lind. Për shembull, Bibla pohon se kohëzgjatja e papastërtisë rituale së nënës është dy herë më e gjatë nëse lind një vajzë sesa kur ajo lind një djalë (Levitiku 12:2-5). Bibla katolike pohon në mënyrë të hapur se:

“Lindja e një femre është një humbje.” (Eklestiasniku 22:3)

Në kontrast me këtë pohim tronditës, djemtë marrin lavdërim të veçantë:

“Një burrë që edukon të birin do të jetë zilia e armikut të tij.” (Eklestiasniku 30:3)

Rabinët çifutë e bënë të detyrueshme për burrat çifutë të prodhojnë trashëgimtarë me qëllim që të përhapin racën. Njëkohësisht, ata nuk e fshehnin parapëlqimin e tyre të hapët për fëmijët meshkuj: **“Është mirë për ata fëmijët e të cilëve janë meshkuj, por keq për ata që kanë vajza”, “Në lindjen e një djali të gjithë janë të lumtur... në lindjen e një vajze të gjithë janë të pikëlluar”** dhe **“Kur vjen në jetë një djalë, paqja vjen në jetë... kur lind një vajzë, nuk vjen asgjë.”**⁷

Vajza konsiderohet një barrë e mundimshme dhe e dhimbshme, një burim potencial turpi për babanë e saj:

“Vajza juaj është kokëfortë, mprehni shikimin që ajo të mos ju bëjë objekt-talljen e armiqve tuaj, përfoljen e qytetit, thashethemet e ulëta dhe t’ju turpërojë para të gjithëve.” (Eklestiasniku 42:11)

“Mbajeni një vajzë kokëfortë nën kontroll të rreptë, përndryshe ajo do shpërdorjë çdo butësi që i jepet. Mbani një vëzhgim strikt mbi syrin e saj të paturp, mos u çudisni nëse ajo ju turpëron juve.” (Eklestiasniku 26:10-11)

Ishte pikërisht kjo ide e të trajtuarit të bijave si burime turpi që i çoi arabët paganë, përpara agimit të Islamit, të praktikojnë infanticid femëror. Kur’ani e dënoi rreptësisht këtë praktikë të tmerrshme dhe të urryer:

“Kur ndonjëri prej jush lajmërohet me lindjen e një vajze, fytyra e tij priset dhe bëhet plot mllef. Fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua. Pastaj (mendon) a ta mbajë atë ashtu në përçmim apo ta mbulojë atë (të gjallë) në dhé? Ah! Sa i keq është ai gjykim i tyre.” (16:58-59)

Duhet përmendur se ky krim ogurzi nuk do kishte reshtur kurrë në Arabi, po të mos ishte për fuqinë e termave të ashpër të Kur'anit në dënim të kësaj praktike (shih 16:59, 43:17, 81:8-9). Kur'ani, përveç kësaj, s'bën dallim ndërmjet djemve dhe vajzave. Në kontrast me Biblën, Kur'ani e konsideron lindjen e femrës si dhuratë dhe bekim nga Zoti, të njëjtë me atë të një mashkulli. Kur'ani madje përmend dhuntinë e lindjes së femrës përpara:

“Vetëm i Allahut është pushteti i qiejve dhe i tokës. Ai krijon çfarë dëshiron, Ai i dhuron fëmijë femra kujtdo që dëshiron e i dhuron fëmijë meshkuj kujtdo që dëshiron.” (42:49)

Për të fshirë nga faqja e dheut të gjitha gjurmët e infanticidit femëror në shoqërinë muslimane që po lindte, Profeti Muhammed (s) u premtoi atyre që ishin bekuar me vajza një shpërblim të madh, nëse do t'i rrisnin ato me butësi:

“Ai që merret me rritjen e bijave dhe (që) pregatit trajtim mirëdashës (të butë) ndaj tyre, ato do të jenë mbrojtje ndaj zjarrit të Xhehenemit për të.” (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi)

“Kushdo që mban (rrit) dy vajza derisa të arrijnë pjekurinë, ai dhe unë do të vijmë në Ditën e Gjykimit kështu” - dhe ai lidhi gishtat e tij. (Transmeton Muslimi)

5. ARSIMIMI I FEMRËS ?

Ndryshimi midis konceptimeve biblike dhe kur'anore të grave nuk kufizohet vetëm te femra e porsalindur, por shtrihet shumë më larg se kaq. Le të krahasojmë qëndrimet e tyre ndaj një femre që përpiket të mësojë fenë e saj.

Zemra e Judaizmit është Teurati, Ligji. Megjithatë, sipas Talmudit, **“Gratë përjashtohen nga studimi i Teuratis.”** Disa Rabinë çifutë pohuan prerazi: **“(Më mirë) Le të shkatërrohen nga flaka fjalët e Teuratis sesa t’u përcillen (njoftohen) grave.”** Në shekullin e parë pas Krishtit, Rabi Eliezer pohonte: **“Kushdo që i mëson Teuratin vajzës së tij, është tamam si t’i ketë mësuar asaj punë të pahijshme.”**⁸

Qëndrimi i Shën Palit në Dhiatën e Re s’është më i mençur:

“Sikurse edhe në të gjitha grumbullimet e shenjtoreve, gratë le të heshtin nëpër kisha. Atyre nuk u lejohet të flasin por duhet të jenë në nënshtrim, siç thotë Ligji. Nëse duan të pyesin për diçka, ato duhet t’u drejtohen burrave të tyre në shtëpi: sepse është paturpësi për një grua të flasë në kishë.” (Korintiansve I, 14:34-35)

E si mund të mësojë një grua nëse ajo nuk lejohet të flasë? E si mundet një grua të ngritet intelektualisht nëse atë e detyrojnë të jetë në një gjendje nënshtrimi të plotë? Si mund t’i zgjerojë ajo horizontet e saj nëse burimi i vetëm i informacionit për të është burri i saj në shtëpi?

Tani, të jemi të ndershëm, duhet të pyesim: a është qëndrimi kur’anor ndopak i ndryshëm? Një ngjarje e shkurtër e treguar në Kur’an e përmbledh saktësisht pozicionin që mban ai. Khawla-ja ishte një grua muslimane burri i së cilës - Aws, në një çast zemërimi e sipër kish shqiptuar këtë fjalë: “Ti më je mua si shpina e nënës sime.” Kjo mbahej nga arabët paganë si pohim divorci që e lironte burrin nga çdo përgjegjësi bashkëshortore por nuk e linte gruan të lirë të linte shtëpinë e të shoqit apo të martohej me një njeri jetër. Pasi kish dëgjuar këto fjalë nga i shoqi, Khawla-ja ishte gjendur në një situatë të mjerueshme. Ajo shkoi drejt e te Profeti (s) për të mbrojtur çështjen e saj. Profeti (s) ishte i mendimit që ajo duhej të tregohej e duruar pasi mesadukej s’kishte rrugëdalje. Khawla-ja vazhdoi të debatonte me Profetin në përpjekje për të shpëtuar martesën e saj të pezulluar. Brenda një kohe të shkurtër ndërhyri Kur’ani; ankesa e Khawla-së ishte pranuar. Verdikti Hyjnor e anulloi përgjithmonë këtë zakon mjerues. Një kaptinë e tërë (Sura 58) e Kur’anit që titullohet *el-Muxhadileb* (“Ajo që po debaton”) iu kushtua këtij incidenti:

“Vërtet, Allahu dëgjoi dhe pranoi fjalën e asaj që debatoi me ty lidhur me burrin e vet, (e) që u ankua te Allahu; dhe Allahu i dëgjon debatimet midis ju të dyve, sepse Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë...” (58:1)

Pra, në konceptin kur'anor një grua ka të drejtë të debatojë madje edhe me vetë Profetin e Islamit (s). Askush s'ka të drejtë t'i mësojë asaj të heshtë. Ajo s'është nën asnjë detyrim ta konsiderojë të shoqin si e vetmja referencë në çështjet e ligjit dhe fesë.

6. GRUAJA – E PASTËR DHE E PËRLYER ?

Ligjet dhe rregullat çifute lidhur me gruan me menstruacione janë jashtëzakonisht shtrënguese. Dhiata e Vjetër e konsideron çdo grua me menstruacione si të papastër dhe të përlyer. Ç'është më e pabesueshme, papastërtia e saj 'infekton' edhe të tjerët. Kushdo apo çfarëdo që ajo prek, bëhet e papastër për një ditë:

“Kur një grua ka derdhjen e saj të rregullt të gjakut, papastërtia e periodës së saj mujore do të zgjasë shtatë ditë, dhe kushdo që e prek atë do të jetë i papastër gjer në mbrëmje. Çdogjë mbi të cilën ajo shtrihet gjatë të përmuajshmeve të saja, do të jetë e papastër dhe çdogjë mbi të cilën ajo ulet do të jetë e papastër. Kushdo që prek shtratin e saj duhet të lajë rrobat e tij dhe të bëjë banjo uji, dhe ai do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Qoftë shtrati, qoftë çfarëdosendi tjetër ku ajo është ulur, kushdo që ta prekë, do të jetë i papastër gjer në mbrëmje.” (Levitiku 15:19-23)

Për shkak të natyrës së saj 'ngjitëse', një grua me menstruacione nganjëherë dëbohej për të shmangur çdo mundësi të çfarëdolloj kontakti me të. Ajo dërgohej në një shtëpi të veçuar e cila quhej “shtëpia e papastërtisë” për tërë periudhën e periodës së saj.⁹ Talmudi e konsideron një grua me menstruacione fatale edhe *pa patur* kontakt fizik:

“Rabinët tanë na mësojnë: ... nëse një grua me zakone kalon midis dy burrave, nëse është në fillim të periodës së saj, ajo do thërë njërin prej tyre, dhe nëse është në fund të periodës së saj, ajo do shkaktojë ngatërresë midis tyre.” (b Pes. 111a.)

Për më tepër, burrit të një gruaje me të përmuajshmet i ndalohej të hynte në sinagogë nëse ai ishte bërë i përlyer nga ajo, madje edhe nga pluhuri nën këmbët e saj. Një klerik - gruaja, motra ose nëna e të cilit ishte me menstruacione - nuk mund të recitonte bekimet priftërore në sinagogë.¹⁰ S'është çudi që shumë gra çifute akoma i referohen menstruacioneve si “mallkimi”.¹¹

Islami nuk e konsideron gruan me menstruacione të zotërojë çfarëdolloj “papastërtie ngjitëse”. Ajo s'është as “e paprekshme”, e as “e mallkuar”. Ajo praktikon jetën e saj normale me të vetmin kufizim: një çift i martuar nuk lejohen të kenë marrëdhënie seksuale gjatë periudhës së menstruacioneve. Çdo kontakt tjetër fizik midis tyre është i lejueshëm. Një grua me menstruacione lirohet nga [kryerja e] disa rituale[ve] si lutjet e përditshme dhe agjërimi, përgjatë të përmuajshmeve të saja.

7. TË DHËNIT DËSHMI

Një tjetër çështje në të cilën Kur'ani dhe Bibla s'pajtohen është ajo e dhënies dëshmi të grave. Është e vërtetë se Kur'ani i ka udhëzuar besimtarët që lidhur me marrëveshjet financiare të marrin dy dëshmitarë burra ose një burrë dhe dy gra (2:282). Megjithatë, është gjithashtu e vërtetë se Kur'ani në situata të tjera pranon dëshminë e një gruaje si të barabartë me atë të një burri. Në të vërtetë, dëshmia e një gruaje mundet madje edhe të zhvleftësojë atë të burrit. Nëse një burrë akuzon gruan e tij për mosbesnikëri, ai detyrohet nga Kur'ani të betohet solemnisht pesë herë si provë e fajit të së shoqes. Nëse gruaje mohon dhe betohet njëllor pesë herë, ajo nuk konsiderohet fajtoare dhe në secilin rast martesë shpërbëhet. (24:6-11)

Nga ana tjetër, gratë nuk janë lejuar të japin dëshmi në shoqëritë e hershme çifute.¹² Rabinët e përfshinin moslejueshmërinë e dhënies dëshmi nga gruaje midis nëntë mallkimeve të rëna mbi të gjitha gratë për shkak të Rënies. (shih kaptinën “Trashëgueset e Evës”) Gratë në Izraelin e sotëm nuk lejohen të japin prova në gjyqet Rabinike sepse Talmudi thotë: **“Gratë janë mendjelehta (dhe) kokëndezura.”**¹³ Rabinët gjithashtu justifikohen pse gratë s'mund të dëshmojnë duke cituar Zanafillën 18:9-16, ku pohohet se Sara, gruaje e Abrahamit, kishte gënjyer. Rabinët e përdorin këtë incident si provë që gratë janë të padenja të japin dëshmi. Duhet patur parasysh këtu se kjo ngjarje e treguar në Zanafillën 18:9-16, është përmendur në Kur'an pa as edhe shenjën më të vogël të çfarëdolloj gënjeshtre nga Sara (shih 11:69-74, 51:24-30). Në Perëndimin e krishterë, si ligji eklesiastik ashtu edhe ai civil, ua ndaloi grave të drejtën e të dhënit dëshmi deri vonë në shekullin e kaluar.¹⁴

Nëse një burrë akuzon gruan e tij për tradhëti, dëshmia e saj nuk do merret parasysh aspak sipas Biblës. Gruaja e akuzuar duhet t'i nënshtrohet një gjyqi mynxyrë (Numrat 5:11-31). Në këtë gjyq, gruaje vihet përballë një rituali kompleks dhe poshtërues që mbahet se do vërtetojë fajin ose pafajësinë e saj. Nëse gjehet fajtoare pas kësaj prove makabre, ajo dënohet me vdekje. Nëse ajo nuk gjehet fajtoare, burri i saj do të jetë i pafajshëm nga çdo shkelje.

Përveç kësaj, nëse një burrë merr një grua si bashkëshorte dhe pastaj e akuzon atë se nuk është e virgjër, të dëshmuarit e saj nuk do ketë rëndësi. Prindërve të saj u duhej të sillnin prova për virgjërinë e vajzës përpara pleqve të qytetit. Nëse prindërit s'mund të vërtetonin pafajësinë e saj, ajo gjuhej me gurë deri në vdekje në pragun e derës së të atit. Nëse prindërit ishin në gjendje të vërtetonin pafajësinë e vajzës, burri vetëm sa gjobitej me njëqind monedha argjendi dhe s'duhej ta ndante të shoqen për të gjithë jetën:

“Nëse një burrë merr një grua dhe, pasi të jetë shtrirë me të, e mospëlqen atë dhe e akuzon për sjellje të pahijshme, dhe i sjell asaj emër të keq duke thënë, ‘U martova me këtë grua, por kur iu qasa, nuk gjeta provë për virgjërinë e saj’, atëherë babai dhe nëna e vajzës do t'u sjellë provë se ajo ishte virgjëreshë pleqve të qytetit të porta. Babai i vajzës do t'u thotë pleqve, ‘Ja dhashë vajzën në martesë këtij njeriu,

por ai s'e pëlqen atë. Tani ai e ka akuzuar atë për vepra të pahijshme dhe më ka thënë se nuk e gjeta virgjëreshë vajzën tënde. Por ja ku është prova e virgjërisë së vajzës sime'. Pastaj prindërit e saj do të shpalosin rrobën përpara pleqve të vendit dhe pleqtë do e marrin burrin dhe do e dënojnë. Ata do e gjobisin atë njëqind *shekele** [*monedha argjendi] dhe do ia japin ato babait të vajzës, sepse ky njeri i ka dhënë emër të keq një vajzeje të Izraelit. Ajo do vazhdojë të jetë e shoqja e tij; ai s'duhet ta ndajë atë gjersa të jetë gjallë. Nëse, megjithatë, akuza është e vërtetë dhe s'mund të gjehet asnjë provë e virgjërisë së vajzës, ajo do sillet tek dera e shtëpisë së të atit dhe aty burrat e qytetit do ta gjuajnë me gurë deri në vdekje. Ajo ka bërë një gjë të paturpët në Izrael duke u bërë e përdalë ende në shtëpinë e të atit. Ju duhet ta pastroni të keqen [gruan] prej jush." (Deuteronomi 22:13-21)

8. ADULTERIA

Pozicioni i gruas, roli, të drejtat dhe detyrat e saj në Kur'an janë shumë të ndryshme nga ato të gjendura në Bibël. Le të marrim disa shembuj.

Adulteria [tradhëtia bashkëshortore] konsiderohet mëkat në të trija fetë. Bibla urdhëron dënimin me vdekje për të dy që kryejnë adulteri (Levitiku 20:10). Islami gjithashtu i dënon njëloj mashkullin dhe femrën adulate (24:2). Megjithatë, përkufizimi kur'anor i adulterisë është shumë i ndryshëm nga ai biblik. Adulteria, sipas Kur'anit është pjesëmarrja e një burri ose gruaje të martuar në një aferë jashtëmartesore. Bibla e konsideron vetëm aferën jashtëmartesore të një *gruaje* si adulteri (Levitiku 20:10, Deuteronomi 22:22, Proverbat 6:20 - 7:27):

“Nëse një burrë gjehet i shtrirë me gruan e një tjetri, si burri që ka fjetur me të, ashtu edhe gruaja duhet të vdesin. Duhet ta spastroni të keqen nga Izraeli.”
(Deuteronomi 22:22)

“Nëse një burrë kryen adulteri me gruan e një tjetri, që të dy - adulteri dhe adulterja duhet të çohen në vdekje.” (Levitiku 20:10)

Sipas përkufizimit biblik, nëse një burrë i martuar fle me një grua të pamartuar, ky nuk konsiderohet krim aspak. Burri i martuar që ka lidhje jashtëmartesore me gra të pamartuara nuk është një adulter, dhe gratë e pamartuara që lidhen me të nuk janë adulate. Krimi i adulterisë kryhet vetëm kur një burrë, qoftë beqar apo i martuar, fle me një grua të martuar. Në këtë rast burri konsiderohet adulter, edhe pse nuk është i martuar, dhe gruaja konsiderohet adulate. Shkurt, adulteria është cilado marrëdhënie seksuale e paligjshme që përfshin një grua të martuar. Marrëdhënia jashtëmartesore e një burri të martuar nuk është *per se** [*lat. - ‘në vetvete’, sh.p.] një krim në Bibël. Përse ky standard moral i dyfytirshëm?

Sipas Enciklopedisë Judaïke, gruaja konsiderohej pronë e burrit dhe adulteria përbënte shkelje të së drejtës ekskluzive të burrit mbi të; gruaja duke qenë pronë e të shoqit s’e kishte një të drejtë të tillë mbi të.¹⁵ Domethënë, nëse një burrë kishte marrëdhënie seksuale me një grua të martuar, ai do dhunonte pronën e një tjetri dhe kështu, ai duhej të dënohej [vetëm për këtë dhunim prone].

Dhiata e Re i bën jehonë të njëjtë qëndrim tek Mateu 5:32 ku i mvishet Jezusit të ketë thënë:

“Po ju them juve se kushdo që divorcon gruan e tij, përveçse për mosbesnikëri bashkëshortore, e bën atë adulate; dhe kushdo që martohet me gruan e divorcuar, kryen adulteri.”

Përse nuk e quajti ai burrin që divorcon të shoqen dhe martohet me një tjetër, adulter?

Edhe sot e kësaj dite në Izrael, nëse një burrë i martuar përshihet në një lidhje jashtëmartesore me një grua, fëmijët e tij nga ajo grua konsiderohen të ligjshëm. Por, nëse një grua e martuar ka një aferë me një burrë tjetër, fëmijët e saj me atë burrë konsiderohen jo vetëm kopila, por atyre u ndalohet të martohen me çdo çifut përveç të kthyerve dhe kopilëve të tjerë. Ky ndalim u bëhet pasardhësve të fëmijës për 10 breza, gjersa njolla e adulterisë supozohet të jetë dobësuar.¹⁶

Kur'ani, nga ana tjetër, nuk e konsideron kurrë asnjë grua të jetë pronë e kujtdo mashkulli:

“Dhe për gratë janë të drejtat mbi burrat të njëjta me ato të burrave mbi gratë.”
(2:228)

Kur'ani e thekson unitetin thelbësor të burrave e grave në mënyrën më të bukur:

“Ato (gratë tuaja) janë rroba juaj dhe ju jeni rrobë për to.” (2:187)

Ashtu siç fshehin rrobat lakuriqësinë tonë, ashtu edhe burri e gruaja, duke hyrë në marrëdhënien e martesës, i sigurojnë njëri-tjetrit nderin. Rroba i jep rehati trupit; po kështu burri gjen rehati në shoqërinë e të shoqes dhe ajo në shoqërinë e tij. “Rroba është mirësia, bukuria, stolisja e trupit - po kështu janë gratë për burrat e tyre siç janë burrat e tyre për to.” Islami nuk e konsideron gruan “një vegël të Djallit”, por përkundrazi Kur'ani e quan atë *mubsana* - fortresë kundër shejtanit, sepse një grua e mirë, duke u martuar me një burrë, e ndihmon atë të ruajë rrugën e ndershmërisë në jetën e tij. Pikërisht për këtë arsye martesë u konsiderua nga Profeti Muhammed (s) si një akt nga më të devotshmit. Ai tha: **“Kur një burrë martohet, ai ka plotësuar gjysmën e fesë së tij.”** Ai ua urdhëroi martesën muslimanëve duke u thënë: **“Martesa është pjesë e rrugës sime dhe kushdo që largohet nga rruga ime, nuk është nga të mijtë.”**

Kur'ani i qorton rreptë ata burra që shtypin apo keqtrajtojnë gratë:

“O’ ju që besoni! Ju ndalohet të trashëgoni gra kundër vullnetit të tyre. E as nuk duhet t’i trajtoni ato me ashpërsi ... Përkundrazi, jetoni me to mbi bazat e dashamirësisë dhe barazisë...” (4:19)

Dhe së fundi, Kur'ani e përshkruan në mënyrë elokumente *raison d'être** [*fr. - arsyen e të qenit] të martesës dhe natyrën e marrëdhënies ndërmjet bashkëshortëve duke thënë:

“Dhe nga shenjat e (madhërisë së) Tij është që, për të mirën tuaj, ai krijoi nga vetë lloji juaj bashkëshorte, ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes zemrave tuaja mbolli dashuri e mëshirë: (me të vërtetë) në këtë ka argumente për ata që mendojnë.” (30:21)

Ky është konceptimi kur'anor i martesës: dashuri, mëshirë dhe qetësi, jo pronësim dhe standarde të dyfishta.

9. BETIMET

Sipas Biblës, një njeri duhet të plotësojë çdo betim që mund t'i bëjë Zotit. Ai s'duhet ta shkelë fjalën e tij. Nga ana tjetër, betimi i një gruaje nuk është domosdoshmërisht detyrues për të. Ai duhet të miratohet nga babai i saj, nëse ajo jeton në shtëpinë e tij, ose nga i shoqi, nëse është e martuar. Nëse një baba/burrë nuk i vulos [vërteton] betimet e të bijës/shoqes, të gjitha zotimet e kryera nga ajo bëhen të pavlefshme:

“Por nëse i ati ia ndalon asaj kur dëgjon për të, asnjë nga betimet e saj ose zotimet të cilat ajo mori përsipër nuk do vlejné... burri i saj mund të konfirmojë apo anullojë cilindo zotim që ajo bën ose ndonjë premtim të betuar për të dëmtuar veten.”
(Numrat 30:5-13)

Përse fjala e një gruaje nuk qenka e qëndrueshme *per se*? Përgjigja është e thjeshtë: sepse ajo është pronë e babait të saj përpara martesës, dhe e të shoqit pas martesës. Kontrolli i babait mbi vajzën e tij ishte absolut deri në atë shkallë sa, nëse dëshironte, ai mund edhe ta shiste atë! Shënohet në shkrimet e Rabinëve se: **“Burri mund ta shesi të bijën, por gruaja s'mund ta shesë atë; burri mund ta fejojë të bijën, po gruaja s'mund ta fejojë atë.”**¹⁷

Literatura rabinike tregon gjithashtu se martesë përfaqëson kalimin e kontrollit nga babai tek burri: **“Fejesa, të bërit e një gruaje pronësim i shenjtë - pronën e padhunueshme - të të shoqit..”** Padyshim, nëse gruaja konsiderohet të jetë prona e dikujt tjetër, ajo s'mund të bëjë asnjëlloj betimi të cilin pronari i saj nuk e aprovon.

Është me interes të theksohet se udhëzimi biblik lidhur me betimet e grave ka patur jehonë të keqe mbi gratë judeo-kristiane deri herët në këtë shekull. Një grua e martuar në Perëndim nuk kishte status ligjor. Asnjë akt i saj s'kishte kurrfarë vlere ligjore. Burri i saj mund t'i mohonte çdo kontratë, marrëveshje apo ujdë që ajo kish bërë. Gratë në Perëndim, i cili është trashëguesi më i madh i traditës judeo-kristiane, mbaheshin të paaftra për të bërë një kontratë të qëndrueshme sepse ato praktikisht pronësoheshin nga dikush tjetër. Gratë e Perëndimit kishin vuajtur për gati dymijë vjet për shkak të qëndrimit biblik ndaj pozicionit të grave *vis à vis** [*fr. - përballë, sh.p.] baballarëve dhe burrave të tyre.¹⁸

Në Islam, betimi i çdo muslimani, mashkull a femër, është detyrues dhe i qëndrueshëm mbi të. Askush nuk e ka pushtetin për të hedhur poshtë betimet e kujtdo tjetri. Të dështuarit për të mbajtur betimin e dhënë solemnisht, të bërë nga një burrë ose një grua, duhet të shlyhet siç është shënuar në Kur'an:

“Ai (Allahu) do t'ju thërrasë që të jepni llogari për betimet tuaja të qëllimta (të vetëdijshme). Për shlyerjen (e fajit të betimit të pambajtur), ushqeni dhjetë nevojtarë, në masën e mesatares së ushqimit të familjes suaj; ose vishini ata; ose jepini një robi

lirinë. Nëse kjo është përtej mundësive tuaja, agjëroni për tre ditë. Kjo është shlyerja për betimet që keni dhënë. Por mbajeni fjalën.” (5:89)

Shokët e Profetit (s), burrat dhe gratë, e kishin zakon të paraqisnin betimin e tyre të besnikërisë ndaj tij personalisht. Gratë, po ashtu si burrat, shkonin të pavarura tek ai dhe i jepnin zotimet e tyre:

“O’ Profet, kur gratë besimtare të vijnë tek ti për të bërë marrëveshje me ty se nuk do përngjisin asgjë në adhurim përveç Allahut e as nuk do vjedhin, as kryejnë amoralitet, as vrasin fëmijët e tyre, as shpifin (përgojojnë) për askënd, as nuk do të të mosbinden në cilëndo çështje të drejtë - atëherë bëj marrëveshje me to dhe lutju Zotit tënd për faljen e gjynaheve të tyre. Me të vërtetë Allahu është falësi dhe më mëshiruesi.” (60:12)

Një burrë s’do mund të betohej asnjëherë në emër të së bijës apo së shoqes. E një burrë as nuk do mund të hidhte kurrë poshtë betimin e bërë nga cilado prej të afërmeve të tija.

10. PRONA E GRUAS ?

Të trija fetë ndajnë një besim të patundur në rëndësinë e martesës dhe jetës familjare. Ato gjithashtu bien dakord për rolin drejtues të bashkëshortit në familje. Prapëseprapë, ndryshime të kumbueshme ekzistojnë në të vërtetë ndërmjet tre feve lidhur me kufijtë e këtij drejtimi. Tradita judeo-kristiane, në ndryshim nga Islami, mund të themi se e tejzgjat rolin drejtues të burrit deri në pronësim të së shoqes.

Tradita çifute në lidhje me rolin e burrit ndaj gruas së tij buron nga koncepti se ai e zotëron atë ashtu siç zotëron një skllave. Ky konceptim ka qenë arsyeja [që qëndron] pas standardit të dyfishtë në ligjet e adulterisë dhe pas të drejtës së burrit të anullojë betimet e të shoqes. Ky konceptim ka qenë gjithashtu përgjegjës për mohimin e çfarëdolloj kontrolli të gruas mbi pronën apo fitimet e saja. Porsa një grua çifute martohej, ajo humbiste plotësisht të drejtën mbi pronën dhe fitimet e saj ndaj burrit. Rabinët çifutë theksonin të drejtën e bashkëshortit mbi pasurinë e së shoqes si një kurorë e pronësimit të saj nga ai: **“Meqë një burrë ka arritur posedimin e gruas, a nuk rrjedh [nga kjo] që ai duhet të vihet në posedim edhe të pronës së saj gjithashtu?”**, dhe **“Meqë ai e ka shtënë në dorë gruan a nuk duhet të shtjerë në dorë edhe pronën e saj?”**²⁰ Kështu, martesë e bënte edhe gruan më të pasur të kthehej praktikisht në person pa një dyshkë. Talmudi e përshkruan gjendjen përfundimtare të gruas në këtë mënyrë:

“Si mund të ketë një grua gjëkafshë; [kur] çdogjë e saja i përket të shoqit? Ç’është e tija është e tija dhe ç’është e saja është gjithashtu e tija... Fitesat e saja dhe çfarë mund të gjejë ajo në rrugë janë po ashtu të tijat. Artikujt shtëpiakë, edhe thërmijat e bukës në tavolinë, janë të tijat. Nëse ajo fton një mik në shtëpinë e saj, ajo do vidhte nga i shoqi...” (San. 71a, Git. 62a)

E vërteta është se pasuria e një femre çifute kishte për qëllim tërheqjen e dorë-kërkuesve. Një familje çifute i caktonte së bijës një pjesë nga prona e babait të saj për t’u përdorur si dhunti në rast martesë. Ishte kjo dhunti që i bënte bijat çifute një barrë të padëshiruar për etërit e tyre. Babait i duhej ta rriste të bijën për vite me rradhë dhe pastaj ta pregatiste për martesë duke i siguruar një dhunti të madhe. Kështu, një vajzë në një familje çifute ishte një përgjegjësi por jo një pasuri.²¹ Kjo detyrë shpjegon përse lindja e një vajze nuk festohej me gëzim në shoqërinë çifute (shih kaptinën ‘Bijat Turpëruese?’). Dhuntia ishte dhurata martesore që i paraqitej dhëndrit nën termat e qiramarrjes. Bashkëshorti praktikisht vepronte si pronari i dhuntisë por ai s’mund ta shiste atë. Nusja humbiste çdo kontroll mbi dhuntinë në çastin e martesës. Për më tepër, prej saj pritej që të punonte pas martesës dhe të gjitha fitesat e saj t’i shkonin të shoqit si shpërblim për mbajtjen e saj që ishte detyra e tij. Ajo mund të rifitonte pasurinë e saj vetëm në dy raste: divorc ose vdekja e të shoqit. Nëse ajo vdiste e para, ai do të trashëgonte pasurinë e saj. Në rast vdekjeje të së shoqit, grua mund të rimerrte pronën e saj paramartesore por asaj nuk i lejohej të trashëgonte asnjë pjesë në pronën e të shoqit të vdekur. Duhet shtuar se dhëndri gjithashtu duhet të paraqiste një dhuratë martesore për nusen, e prapëseprapë ai ishte pronari i ligjshëm i kësaj dhurate për aq gjatë sa të ishin të martuar.²²

Krishterimi, deri vonë, ka ndjekur të njëjtën traditë çifute. Të dyja, si autoritetet religjioze, si ato civile në Perandorinë Kristiane Romake (pas Konstantinit) kërkonin medoemos një marrëveshje pronësie si kusht për njohjen e martesës. Familjet u ofronin bijave të tyre dhunti gjithnjë e më të mëdha; si rrjedhojë, burrat prireshin të martoheshin më herët ndërsa familjet i shtynin martesat e bijave deri më vonë nga ç'ishte e zakonit.²³ Nën ligjin kanunor, një gruaja i jepej e drejta t'i kthehej dhuntia e saj nëse martesa e saj zhbëhej, përveç në qoftë se ajo ishte fajtores për adulteri. Në rast të tillë, ajo humbiste të drejtën e saj mbi dhuntinë, e cila mbetej në duart e të shoqit.²⁴ Nën ligjin kanunor dhe civil, një grua e martuar në Evropën dhe Amerikën e krishterë kishte humbur të drejtat mbi pasurinë e saj deri vonë në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe herët në shekullin e njëzetë. Për shembull, të drejtat e grave nën ligjin anglez ishin përpiluar dhe botuar më 1632. Këto 'të drejta' përfshinin: **“Ajo që burri ka është e tija. Ajo që gruaja ka është e të shoqit.”**²⁵ Gruaja jo vetëm që humbi pronën e saj me t'u martuar, ajo humbi edhe personalitetin e saj gjithashtu. Asnjë akt i saj nuk ishte i vlefshëm ligjërish. Bashkëshorti i saj mund të zhbënte çdo shitje apo dhuratë të bërë nga ajo si diçka që nuk mban vlerë të qëndrueshme ligjore. Ky person me të cilin ajo kishte çfarëdolloj kontrate mbahej si kriminel për pjesëmarrje në një mashtrim. Për më tepër, ajo s'mund të padiste apo të paditej në emër të saj, e as nuk mund të padiste të shoqin.²⁶ Gruaja thjesht i përkiste të shoqit dhe si rrjedhim humbiste pasurinë, personalitetin e saj ligjor dhe emrin e familjes së saj.²⁷

Islami, që nga shekulli i shtatë pas Krishtit, u ka dhuruar grave të martuara personalitetin e pavarur që Perëndimi judeo-kristian u ka mohuar deri shumë vonë. Në Islam, nusja dhe familja e saj s'janë nën asnjë detyrim të çfarëdollojshëm të paraqesin një dhuratë për dhëndrin. Vajza në një familje muslimane nuk është kurrfarë ngarkese apo barre. Një grua është aq e lartësuar nga Islami saqë asaj nuk i duhet të paraqesë dhurata me qëllim që të tërheqi burra potencialë. Është *dhëndri* ai që duhet t'i paraqesë detyrimisht nuses një dhuratë martesore. Kjo dhuratë konsiderohet prona e saj dhe as dhëndri e as familja e nuses s'kanë asnjë pjesë apo kontroll mbi të. Në disa shoqëri muslimane sot, një dhuratë martesore prej njëqind mijë dollarësh në diamante nuk është e pazakontë.²⁸ Nusja i mban dhurata e saj martesore edhe n.q.s më pas divorcohet. Burrit nuk i lejohet asnjë pjesë në pronën e gruas përveç asaj që ajo i ofron me dëshirën e saj të lirë.²⁹ Kur'ani e ka pohuar pozicionin e vet në këtë çështje tepër qartë:

“Dhe jepuni grave (në martesë) dhuntinë e tyre si dhuratë falas: por nëse ato, nga vullneti dhe dëshira e tyre e mirë, ju falin ndonjë pjesë të saj juve, merreni dhe shijojeni me gëzim të drejtë e të mirë.” (4:4)

Prona dhe fitesa e gruas janë nën kontroll të plotë të saj dhe vetëm për përdorimin e saj, meqënëse mbajtja e saj dhe e fëmijëve është përgjegjësi e të shoqit.³⁰ Pavarësisht sa e pasur mund të jetë një grua, ajo nuk është e detyruar të veprojë si bashkësiguruese [të ardhurash] për familjen e saj përveçse nëse zgjedh me dëshirë dhe vullnet të saj të lirë ta bëjë këtë. Bashkëshortët trashëgojnë nga njëri-tjetri. Për më tepër, një grua e martuar në Islam e ruan personalitetin e saj ligjor dhe mbiemrin.³¹ Një gjykatës amerikan komentoj në një rast mbi të drejtat e grave muslimane, duke thënë: “Një vajzë muslimane mund të martohet disa

herë, por individualiteti i saj nuk gllabërohet nga ai i bashkëshortëve të ndryshëm. Ajo është një planet i vetëm me një emër dhe personalitet ligjor të sajın.”³²

11. DIVORCI

Tre fetë kanë ndryshime të dallueshme në qëndrimet e tyre ndaj divorcit. Krishtërimi e urren divorcin në tërësi. Dhiata e Re mbron patundshëm pazgjidhshmërinë e martesës. I mvishet Jezusit (a.s) të ketë thënë: **“Por unë po ju them se kushdo që divorcon gruan e tij, përveçse për mosbesnikëri bashkëshortore, e bën atë adultere; dhe kushdo që martohet me gruan e divorcuar, kryen adulteri.”** (Mateu 5:32) Ky ideal i pakompromis është, padyshim, jorealit. Ai supozon një gjendje përkryeshmërie morale të cilën shoqëritë njerëzore nuk e kanë arritur kurrë. Kur një çift arrin në përfundimin se jeta e tyre martesore është përtej çdo ndreqjeje a përmirësimi, një ndalim i divorcit nuk do i bëjë atyre asnjë të mirë. Të detyrosh me forcë çifte të keq-kombinuara që të mbesin së bashku kundër vullnetit të tyre s’është as efikase dhe as e arsyeshme. S’duhet habitur përse e gjithë bota e krishterë është detyruar ta miratojë divorcin.

Judaizmi, nga ana tjetër, lejon divorcin pa asnjë shkak. Dhiata e Vjetër i jep burrit të drejtën të divorcojë të shoqen edhe nëse atij ajo thjesht s’i pëlqen:

“Nëse një burrë martohet me një grua që bëhet e pakënaqshme për të sepse ai gjen ndonjëgjë të pahijshme për të, dhe i shkruan asaj një certifikatë divorci, ia jep asaj dhe e nis atë nga shtëpia e tij; dhe nëse pasiqë lë shtëpinë e tij ajo bëhet e shoqja e një tjetri, dhe burri i saj i dytë e mospëlqen e i shkruan asaj një certifikatë divorci, ia jep asaj dhe e nis nga shtëpia, ose nëse vdes, atëherë burri i saj i parë që e ndau atë, nuk lejohet të martohet me të përsëri pasiqë ajo të jetë ndyrë.” (Deuteronomi 24:1-4)

Vargjet e mësipërme kanë shkaktuar debat të konsiderueshëm midis studiuesve çifutë për shkak të mospajtitimit të tyre rreth shpjegimit të fjalëve ‘e pakënaqshme’, ‘pahijshmëri’ dhe ‘mospëlqen’ të përmendura në to. Talmudi shënon qëndrimet e tyre të ndryshme:

“Shkolla Shammai pohonte se një njeri s’duhet ta divorconte të shoqen gjersa ta gjejë atë fajtores për ndonjë keqsjellje seksuale, ndërsa shkolla Hillel thotë se ai mund ta divorcojë atë edhe nëse ajo thjesht ka thyer një pjatë të tijën. Rabi Akiba thotë se ai mund ta divorcojë atë edhe nëse ai thjesht gjen një grua më të bukur se ajo.” (Gittin 90 a-b)

Dhiata e Re ndjek opinionin e Shammaitëve ndërsa ligji çifut ka ndjekur opinionin e Hillelitëve dhe Rabi Akibas.³³ Meqë mbizotëroi mendimi i Hillelitëve, u bë traditë e pashkelshme e ligjit çifut që t’i japë burrit liri për ta ndarë të shoqen pa asnjëfarë shkak. Dhiata e Vjetër jo vetëm që i jep burrit të drejtën për të divorcuar gruan e tij “të pakëndshme”, ajo e konsideron ndarjen e një “gruaje të keqe” obligim:

“Një grua e keqe sjell poshtërim, shikime buzëplasma dhe zemër të plagosur. I një dore të butë dhe gjuri të dobët është njeriu gruaja e të cilit dështon ta gëzojë atë.

Gruaja është burimi i mëkatit, dhe prej saj ne vdesim. Mos lini një kazan pikues të rrjedhi i tëri apo një grua të keqe të thojë ç’i pëlqen. Nëse ajo nuk pranon mbikqyrjen tuaj, ndajeni atë dhe shporreni larg.” (Ekleziastiku 25:25)

Talmudi ka shënuar shumë veprime të veçanta nga gratë të cilat i obligonin bashkëshortët t’i ndanin ato: **“Nëse ajo ha në rrugë, nëse ajo pi me lakmi në rrugë, nëse ajo pi gji në rrugë - në secilin rast Rabi Meir thotë se ajo duhet të lërë të shoqin.”** (Git. 89a) Talmudi e ka bërë gjithashtu urdhëresë të mbaruar divorcimin e një gruaje shterpe (që nuk ka lindur fëmijë për një periudhë prej dhjetë vjetësh): **“Rabinët tanë na mësojnë: Nëse një burrë merr një grua dhe jeton me të për dhjetë vjet dhe ajo nuk i lind fëmijë, ai duhet ta divorcojë atë.”** (Yeb. 64a)

Gratë, nga ana tjetër, nuk mund të nisin procedurë divorci nën ligjin çifut. Një grua çifute, megjithatë, mund të kërkonte të drejtën për divorc përpara një gjyqi çifut me kusht që të ekzistojë një arsye e fortë. Shumë pak terren gjendet për gruan të bëjë një kërkesë për divorc. Ky terren përfshin: një burrë me të meta fizike ose sëmundje lëkure, një burrë që nuk kryen detyrat martesore, etj. Gjyqi mund ta mbështesi kërkesën e gruas për divorc por ai nuk mund ta shpërbejë martesën. Vetëm burri mund ta zhbëjë martesën duke i dhënë gruas së tij një shkresë divorci. Gjyqi mund ta kamxhikonte, gjobiste, burgoste dhe shkishëronte atë për ta detyruar me forcë që të lëshonte shkresën e kërkuar të divorcit për të shoqen. Mirëpo, nëse burri është mjaft kokëfortë, ai mund të refuzojë t’i japë së shoqes divorcin dhe ta mbajë kështu të lidhur pas tij pambarim. Edhe më keq akoma, ai mund ta braktisë atë pa i siguruar asaj divorc dhe duke e lënë atë të pamartuar dhe të padivorcuar. Ai mund të martohet me një grua tjetër dhe madje të jetojë me cilëndo grua beqare t’ia dojë qefi dhe të ketë fëmijë nga ajo (këta fëmijë konsiderohen të ligjshëm nën ligjin çifut). Gruaja e braktisur, nga ana tjetër, s’mund të martohet me asnjë burrë të dytë ngaqë me ligj ajo është ende e martuar dhe ajo gjithashtu s’mund të jetojë me cilindo burrë tjetër sepse do të konsiderohet adultere dhe fëmijët e saj nga kjo lidhje do të jenë të paligjshëm për dhjetë breza. Një grua në një pozicion të tillë thërritet *agunah* (‘grua në zinxhirë’).³⁴ Në Shtetet e Bashkuara sot [1995] ka rreth 1000 deri 1500 gra çifute që janë *agunot* (shumësi i *agunah*), ndërsa në Izrael numri i tyre mund të jetë aq i lartë sa 16000. Burrat mund të zhvasin qindra mijëra dollarë nga gratë e tyre të zëna grackë në këmbim të një divorci çifut.³⁵

Islami zë pozicionin e mesëm ndërmjet Krishtëritimit dhe Judaizmit në lidhje me divorcin. Martesa në islam është një lidhje e shenjtëruar që nuk duhet thyer përveçse për arsye detyruese. Çiftet janë të udhëzuara të ndjekin të gjitha mjetet e mundura [pajtuese] kurdoherë që martesat e tyre janë në rrezik. Divorci nuk duhet përdorur përveçse kur është e vetmja rrugëzgjdhje. Në thelb, Islami e njeh divorcin, mirëpo e dekurajon atë me të gjitha mënyrat. Le të përqendrohemi në anën e të njohurit të tij në fillim. Islami e njeh të drejtën e të dy partnerëve për t’i dhënë fund marrëdhënies martesore. Islami i jep burrit të drejtën për *Talāk* (divorc). Për më tepër, Islami - ndryshe nga Judaizmi - i jep të drejtën gruas ta shpërbejë martesën përmes asaj që njihet si *Khula*.³⁶ Nëse burri e zhbën martesën duke e divorcuar të shoqen, ai nuk mund të tërheqi asnjërin prej dhuratave të martesës që i ka dhënë asaj. Kur’ani i ndalon haptazi dhe prerazi burrat divorcues nga të marrit mbrapsht të dhuratave martesore, sado të shtrenjta apo të vlefshme të jenë ato:

“Por nëse vendosni të merrni një grua në vend të një tjetre, edhe nëse i keni dhënë kësaj një thesar të tërë, mos tërhiqni mbrapsht asnjë grimë nga ajo; a do e merrnit atë përmes përfoljesh dhe gabimi të hapur?” (4:20)

Në rastin e gruas që vendos të përfundojë martesën, ajo mund t’ia kthejë dhuratat e martesës së shoqit. Të kthyerit e dhuratave të martesës në këtë rast është një kompensim i ndershëm për burrin që dëshiron ta mbajë të shoqen ndërkohë që ajo zgjedh ta lërë atë. Kur’ani i ka udhëzuar burrat muslimanë të mos marrin mbrapsht asnjë nga dhuratat që u kanë dhënë grave të tyre përveç rastit kur është gruaja ajo që zgjedh t’i japi fund martesës:

“Nuk ju lejohet juve (burrave) të tërhiqni mbrapsht cilëndo nga dhurata tuaja përveç (rastit) kur të dyja palët druajnë se s’mund të mbajnë kufijtë e urdhëruar nga Allahu. Nuk fajësohet asnjëri prej tyre nëse ajo jep diçka me vullnet të lirë. Këto janë kufizimet e urdhëruara nga Allahu, prandaj mos i shkelni ato.” (2:229)

Gjithashtu, një grua edhe te Profeti Muhammed (s) duke kërkuar shpërbërjen e martesës së saj; ajo i tha Profetit se nuk kishte anjë ankesë kundër karakterit apo sjelljes së të shoqit. Problemi i saj i vetëm ishte se ajo sinjerisht nuk e pëlqente atë deri në masën sa të mos mund të jetonte me të. Profeti (s) e pyeti: “A do i ktheje atij kopshtin e vet (dhuratën e martesës që ai i kishte bërë asaj)?” Gruaja u përgjigj: “Po”. Profeti (s) atëherë e udhëzoi burrin të merrte përsëri kopshtin e vet dhe të pranonte shpërbërjen e martesës. (Buhariu)

Në disa raste, një bashkëshorte muslimane mund të dëshirojë ta ruajë martesën por e sheh veten të detyruar të kërkojë divorc për shkak të disa arsyeve detyruese si: ashpërsi e të shoqit, braktisje pa një arsye, një burrë që nuk kryen detyrat martesore, etj. Në këto raste gjyqi musliman e shpërbën martesën.³⁷

Shkurt, Islami i ka ofruar gruas muslimane disa të drejta të pashoqe: ajo mund ta përfundojë martesën përmes *Khula*’-së dhe ajo mund të hedhë në gjyq për divorc. Një grua muslimane s’mund të bëhet kurrë e prangosur nga një burrë i pabindur. Ishin pikërisht këto të drejta ato që i joshën gratë çifute që jetuan në shoqëritë e hershme islame të shekullit të shtatë p.K. të synonin marrjen e kërkesave të divorcit nga burrat e tyre çifutë, nëpërmjet gjykatave muslimane. Rabinët i deklaruan këto shkresa të pavlefshme dhe boshe. Për t’i dhënë fund kësaj praktike, Rabinët i dhanë të drejta dhe privilegje të reja grave çifute në përpjekje për të dobësuar tërheqjen e gjykatave muslimane. Grave çifute që jetonin në vendet e krishtera nuk u ofroheshin kurrfarë privilegjesh ngaqë ligji romak i divorcit i praktikuar atje s’ishte aspak më tërheqës se ligji çifut.³⁸

Le ta përqendrojmë vëmendjen tonë tani në atë se si e dekurajon Islami divorcin. Profeti i Islamit (s) u tha besimtarëve:

“Midis të gjitha veprimeve të lejuara, divorci është më i urreyeri te Zoti.” (Abu Dawood-i)

Një burrë musliman nuk duhet ta divorcojë të shoqen vetëm pse atij s'i pëlqen ajo. Kur'ani i Lartësuar i udhëzoi burrat muslimanë të jenë të butë me gratë edhe në raste emocionesh apo ndjenjash të vokëta mospëlqimi:

“Jetoni me to (gratë tuaja) mbi bazën e mirësisë (butësisë) dhe barazisë. Nëse i mospëlqeni ato, ndoshta ju nuk pëlqeni diçka mbi të cilën Allahu ka vendosur një të mirë të madhe.” (4:19)

Profeti Muhammed (s) dha një udhëzim të ngjashëm:

“Një besimtar s'duhet ta urrejë një besimtare. Nëse ai e mospëlqen njërin nga tiparet e saja ai do të kënaqet (jetë i lumtur) me një tjetër.” (Muslimi)

Profeti (s) gjithashtu ka theksuar se muslimanët më të mirë janë ata që janë më të mirë ndaj bashkëshorteve:

“Besimtarët që tregojnë besimin më të përkryer janë ata që kanë karakterin më të mirë - dhe më të mirët ndër ju janë më të mirët ndaj grave të tyre.” (Tirmidhi-u)

Megjithatë, Islami është një fe praktike dhe ajo e njeh [faktin] se ekzistojnë rrethana në të cilat një martesë vjen në buzë të shkatërrimit. Në raste të tilla një këshillë e thjeshtë mirësie apo vetë-përmbajtjeje nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Prandaj, ç'duhet bërë me qëllim që të shpëtohet martesë në raste të tilla? Kur'ani ofron disa këshilla praktike për bashkëshortin (gruan apo burrin) partneri i të cilit është i padrejti. Për burrin keqsjellja e gruas të së cilit kërcënon martesën, Kur'ani jep katër lloje këshillash, siç shpjegohet në vargjet e mëposhtme:

“Përsa i përket grave nga ana e të cilave ju druani mosbesnikëri dhe keqsjellje: (1) Paralajmërojini ato; (2) kundërshtoni të ndani shtratin me to; (3) rrahini ato; por nëse ato kthehen në bindje mos synoni kundra tyre mjete bezdie: sepse Allahu është më i Lartësuari, më i Madhi. Nëse druani ndarje midis tyre, caktoni dy ndërmjetës, një nga familja e tij dhe një nga e saja; nëse ata dëshirojnë paqen, Allahu do të sjellë pajtimin e tyre.” (4:34-35)

Tre masat e para duhen provuar në fillim. Nëse ato dështojnë, atëherë duhet kërkuar ndihma e familjeve të përfshira. Duhet theksuar, në dritën e vargjeve të mësipërme, se të rrahurit e gruas rebeluese është një masë e përkohshme që rradhitet si e treta në vijën e rasteve të nevojës së skajshme në shpresë që kjo mund të ndalojë të vepruarit e padrejtë të gruas. Nëse ajo ka efekt, burri nuk lejohet në asnjë mënyrë të vazhdojë çfarëdolloj trazimi ndaj të shoqes siç përmendet qartë në varg. Nëse kjo nuk sjell dobi, burri përsëri nuk lejohet ta përdorë këtë më tej dhe rruga përfundimtare e pajtimit të ndihmuar nga familjet duhet shqyrtuar.

Profeti Muhammed (s) i ka udhëzuar burrat muslimanë se ata s'duhet të kërkojnë ndihmë nga këto mjete përveçse në raste ekstreme si p.sh një paturpësi e hapur e kryer nga gruaja. Edhe në këto raste madje, dënimi duhet të jetë i lehtë dhe nëse gruaja pushon, burrit nuk i lejohet ta zemërojë atë:

“Në rast se janë fajtorë për paturpësi të hapur, ju mund t’i lini ato të vetme në shtratet e tyre dhe t’u jepni një dënim të lehtë. Nëse ato ju binden, mos kërkonin asnjë mjet trazimi kundër tyre.” (Tirmidhi-u)

Për më tepër, Profeti i Islamit (s), ka dënuar çfarëdolloj të rrahuri të pashkak. Disa gra muslimane iu ankuan atij se burrat e tyre i kishin rrahur. Me të dëgjuar këtë, Profeti pohoi kategorikisht se:

“Ata prej jush që bëjnë kështu (rrahin gratë), nuk janë të mirët ndër ju.” (Abu Dawood-i)

Duhet mbajtur mend këtu se Profeti (s) ka thënë gjithashtu:

“Më i miri ndër ju është ai që është më i mirë ndaj familjes së tij, dhe ndër ju unë jam më i miri ndaj familjes sime.” (Tirmidhi-u)

Duhet theksuar se Talmudi e miraton të rrahurin e gruas si një ndëshkim për hir të disiplinës.³⁹ Burri [për këtë] nuk kufizohet në raste ekstreme si ai i paturpësisë së hapur. Atij i lejohet ta rrahi të shoqen edhe nëse ajo thjesht refuzon të bëjë punët e shtëpisë. Për më tepër, ai nuk është i kufizuar vetëm në përdorimin e dënimit të lehtë. Atij i lejohet ta thyjë kokëfortësinë e së shoqes nëpërmjet kamxhikut ose duke e lënë pa ngrënë.⁴⁰

Për gruan, keqsjellja e burrit të së cilës është shkaku i shkuarjes në buzëgreminë të martesës, Kur’ani ofron këshillën e mëposhtme:

“Nëse një grua druan ashpërsi apo braktisje nga ana e të shoqit, ata nuk fajësohen po të ujdin një marrëveshje miqësore ndërmjet tyre; dhe një e tillë marrëveshje është më e mira (gjë).” (4:128)

Në këtë rast, gruaja këshillohet të kërkojë pajtim me të shoqin (me ose pa ndihmën e familjes). Është për t’u dalluar se Kur’ani nuk e udhëzon gruan të kërkojë rrugëdalje me anë të dy masave të abstenimit nga seksi dhe të rrahurit. Arsyeja për këtë pabarazi mund të jetë të mbrojturit e gruas nga një reagim i dhunshëm fizik nga i shoqi, edhe ashtu i keqsjellur. Një reagim i tillë i dhunshëm fizik do t’i sjellë si gruas ashtu edhe martesës më shumë dëm sesa dobi. Disa dijetarë muslimanë kanë sugjeruar që gjykata mund t’i zbatojë këto masa

kundër burrit në emër të së shoqes. Kjo d.t.th se gjyqi në fillim paralajmëron burrin rebelues, pastaj e ndalon atë nga shtrati i së shoqes dhe së fundi ekzekuton një rrahje simbolike.⁴¹

Për të përmbledhur, Islami i ofron çifteve të martuara shumë këshilla të vlefshme për të shpëtuar martesat e tyre në raste trazimi dhe shqetësimi. Nëse njëri prej partnerëve po e vë në rrezik marrëdhënien martesore, partneri tjetër këshillohet nga Kur'ani të bëjë ç'është e mundur dhe efikase për të shpëtuar këtë lidhje të shenjtë. Nëse të gjitha masat dështojnë, Islami i lejon partnerët të ndahen paqësisht dhe miqësisht.

12. NËNAT

Dhiata e Vjetër në disa vende urdhëron trajtim të butë dhe të vëmendshëm të prindërve dhe dënon ata që nuk i nderojnë këta. Për shembull: **“Nëse kushdo shan babain ose nënën, ai duhet të çohet në vdekje.”** (Levitiku 20:9) dhe **“Një burrë i mençur i sjell gëzim babait të tij, por (vetëm) një i marrë përbuz të ëmën.”** (Proverbat 15:20) Megjithëse vetëm të nderuarit e babait [nga prindërit] përmendet në disa vende, si p.sh. **“Një njeri i mençur i kushton vëmendje këshillës së të atit.”** (Proverbat 13:1), vetë nëna nuk përmendet asnjëherë. Për më tepër, nuk vihet ndonjë theks i veçantë mbi të trajtuarit e nënës me mirësi si shenjë vlerësimi i vuajtjes së saj të madhe në shtatzani dhe në të rriturit e tij. Përveç kësaj, nënat nuk trashëgojnë aspak nga fëmijët e tyre ndërkohë që etërit trashëgojnë.⁴²

Është e vështirë të flasësh për Dhiatën e Re si një shkrim që bën thirrje të nderohen nënat. Përkundrazi, të krijohet përshtypja se Dhiata e Re e konsideron trajtimin e butë të nënave si një pengesë në rrugën e Zotit. Sipas Dhiatës së Re nuk mund të bëhesh kristian i mirë që meriton të bëhet një dishepull i Krishtit nëse nuk e urren nënën tënde. I mvishet Jezusit (a.s) të ketë thënë:

“Nëse kushdo vjen tek unë dhe nuk e urren të atin dhe të ëmën, gruan dhe fëmijët e tij, vëllezërit dhe motrat e tija - po, edhe vetë jetën e tij - ai nuk mund të jetë dishepulli im.” (Luka 14:26)

Për më tepër, Dhiata e Re paraqet një pamje të Jezusit si indiferent dhe madje mosrespektues ndaj nënës së tij. Për shembull, kur ajo kishte ardhur për ta kërkuar ndërkohë që ai po i predikonte një turme, ai nuk e çau kokën të shkonte për ta takuar:

“Pastaj nëna dhe vëllezërit e Jezusit arritën. Duke qëndruar mënjanë, ata dërguan dikë për ta thirrur atë. Një turmë njerëzish ishte ulur përreth tij dhe i thanë: ‘Nëna dhe vëllezërit tuaj janë përjashta dhe të kërkojnë.’ ‘Kush janë nëna dhe vëllezërit e mi?’, pyeti ai. Pastaj ai vështroi të ulurit përreth tij dhe tha, ‘Ja ku janë nëna dhe vëllezërit e mi! Kushdo që zbaton vullnetin e Zotit është vëllai, motra dhe nëna ime.’” (Marku 3:31-35)

Dikush mund të argumentojë se Jezusi po përpiqej t’i mësonte auditorit të tij një leksion të rëndësishëm - që lidhjet religjioze s’janë më pak të rëndësishme se ato familjare. Megjithatë, ai mund t’ua kish mësuar dëgjuesve të tij të njëjtin leksion pa treguar një indiferencë të tillë absolute ndaj së ëmës. I njëjti qëndrim mosrespektues portretizohet kur ai refuzoi të mbështesë një pohim të bërë nga njëra prej dëgjuesve që bekoi rolin e nënës së vet në të lindurit dhe rriturit e tij:

“Ndërkohë që Jezusi po thonte këto gjëra, një grua në turmë thirri ‘E bekuar është nëna që të lindi dhe të rriti ty!’ Ai u përgjigj, ‘Përkundrazi, të bekuar janë ata që dëgjojnë fjalën e Zotit dhe i binden asaj’.” (Luka 11:27-28)

Madje, në këtë paraqitje të Jezusit si mosrespektues ndaj nënës në Dhiatën e Re, shkohet edhe më tej. Tek Gjoni 2:4, lexojmë:

“Jezusi iu përgjigj Maries: ‘Grua, se ç’do të bëj unë, është puna ime e jo puna jote.’”

Nëse një nënë e përmasave të virgjëreshës Marie është trajtuar me një mosnjerëzi dhe mosnderim të tillë siç paraqitet në Dhiatën e Re, nga një bir i përmasave të Jezusit (a.s), atëherë si duhet të trajtohet një nënë mesatare kristiane nga bijtë e saj mesatarë kristianë?

Në Islam, nderimi, respekti dhe vlerësimi që i përngjitet amshmërisë është i pashoq. Kur’ani i kushton një rëndësi të veçantë mirësisë ndaj prindërve si e dyta menjëherë pas adhurimit të Zotit Fuqiptotë:

“Zoti yt ka urdhëruar prerazi që të mos adhuroni tjetër pos Tij, dhe të silleni bamirësisht ndaj prindërve. Nëse njëri prej tyre apo të dy arrijnë moshë të thyer pranë kujdesit tënd, mos u thuaj as edhe një ofshamë, e as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, por drejtoju me fjalë nderuese. Dhe, me mirësi (në shenjë mëshire) shtrije pranë tyre krahun në përulje (e respektim) e thuaj: ‘Zoti im! Mëshiroji ata të dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël’.” (17:23-24)

Në disa vende të tjera Kur’ani vë një theks të veçantë mbi rolin e madh të nënës në lindje dhe rritje [të fëmijës]:

“Ne e urdhëruam njeriun të jetë i mirë ndaj prindërve të vet: nëna e tij stërmundim pas stërmundimi e mbarti dhe me vuajtje e lindi, e bartja megjithë gjidhënien e tij zgjat tridhjetë muaj (e ai vazhdon të jetojë) derisa të arrijë pjekurinë e vet...” (31:14)

Vendi shumë i veçantë i nënave në Islam është përshkruar në mënyrë elokvente nga Profeti Muhammed (s):

“Një njeri e pyeti profetin: **‘Kë duhet të nderoj më shumë?’**; Profeti iu përgjigj: **‘Nënë tënde.’ ‘Kush vjen më pas?’** pyeti njeriu. Profeti u përgjigj: **‘Nëna jote.’ ‘Po pastaj?’** pyeti njeriu. Profeti u përgjigj: **‘Nëna jote!’ ‘E më pas?’** pyeti përsëri njeriu. Profeti u përgjigj: **‘Babai yt’.**”

Mes të paktave mësimëve të Islamit që muslimanët nderojnë ende sot e kësaj dite është trajtimi i kujdesshëm i nënave. Nderimi që nënat muslimane marrin nga bijët dhe bijat e tyre është shembullor. Marrëdhëniet zjarhtësisht të ngrohta midis nënave muslimane dhe fëmijëve të tyre, si dhe respekti i thellë me të cilin burrat muslimanë u drejtohen nënave të tyre zakonisht i mahnit perëndimorët.⁴³

E ç’përshkrim më i plotë i pozicionit të nënave në Islam mund të gjehet sesa vetë fjalët e Profetit Muhammed (s):

“Parajsa shtrihet nën thembrat e nënave.”

13. TRASHËGIMIA E FEMRËS ?

Një nga ndryshimet më të rëndësishme ndërmjet Kur'anit dhe Biblës është qëndrimi i tyre ndaj trashëgimit nga ana e femrës e pronës së një të afërmi të vdekur. Qëndrimi biblik është përshkruar në mënyrë përmbledhëse nga Rabi Epstein: **“Tradita e vazhduar dhe e pashkelur që nga ditët e Biblës nuk i dha pjesëtareve të shtëpisë - gruas dhe bijave, asnjë të drejtë trashëgimie të pasurisë së familjes. Në skemën më të hershme të trashëgimisë, pjesëtarët e familjes konsideroheshin pjesë e pronës dhe aq të largëta nga personaliteti ligjor i një trashëgimtari, sa (edhe) një skllav. Kurse sipas dekretit të Moisiut, bijat pranoheshin në trashëgimi në rastin kur asnjë pjesëtar mashkull nuk kishte mbetur, ndërsa gruaja nuk konsiderohej si trashëgimtare as në kushte të tilla.”**⁴⁴ Përse pjesëtarët femra të familjes konsideroheshin si pjesë e pronës së familjes? Rabi Epstein e ka përgjigjen: **“Ato janë të pronësuara, para martesës - nga babai; pas martesës - nga i shoqi.”**⁴⁵

Rregulli biblik i trashëgimisë nënvizohet tek Numrat 27:1-11. Një bashkëshorteje nuk i jepet asnjë pjesë në pronën e të shoqit, kurse ai është trashëguesi i parë i saj - edhe para fëmijëve madje. Një bijë mund të trashëgojë vetëm nëse nuk ekziston asnjë trashëgimtar i saj mashkull. Nëna nuk është aspak trashëguese (e bijës), ndërkohë që babai është. Të vejat dhe bijat, në rastin kur mbeteshin fëmijë meshkuj, ishin në mëshirën e trashëgimtarëve meshkuj për t'u mbajtur. Ja pse të vejat dhe jetimet ishin nga më të këputurit e shoqërisë çifute.

Kristianizmi ka ndjekur të njëjtën rrugë për një kohë të gjatë. Si ligji eklesiastik ashtu edhe ai civil i Kristendomit u ndalonte bijave të ndanin me vëllezërit të marrurit pjesë në pronën e trashëguar të babait. Përveç kësaj, gratë ishin të deprivuara nga çfarëdo lloji të drejte trashëgimi. Këto ligje të pabarabarta e tejet të padrejta mbijetuan deri vonë në shekullin e kaluar.⁴⁶

Mes arabëve paganë, të drejtat trashëguese kufizoheshin ekskluzivisht për të afërmit meshkuj. Kur'ani i ndaloi përgjithmonë këto zakone të padrejta dhe i dha të gjitha të afërmeve femra pjesën që u takon:

“Prej asaj që lihet nga prindërit dhe më të afërmit, ka pjesë për burrat dhe pjesë për gratë, qoftë prona e vogël apo e madhe - një pjesë e përcaktuar (mirë).” (4:7)

Nënat, bashkëshortet, bijat dhe motrat muslimane kanë marrë të drejta trashëgimie njëmijë e treqind vjet përpara se Evropa të njihnte se këto të drejta madje ekzistonin ndopak. Ndarja e trashëgimit është një temë e gjërë me një sasi të jashtëzakonshme hollësirash (4:7, 11, 12, 176). Rregulla e përgjithshme është se pjesa e femrës është gjysma e asaj të mashkullit, përveç në rastet kur nëna merr pjesë të barabartë me atë të babait. Kjo rregull e përgjithshme nëse merret e ndarë nga ligjet e tjera lidhur me burrat dhe gratë, mund të

duket e padrejtë. Për të kuptuar racionalen [që qëndron pas kësaj], duhet marrë parasysh fakti se detyrimet financiare të burrave në Islam i tejkalojnë së tepërmi ato të grave (Shikoni kaptinën 'Prona e Gruas?'). Një dhëndër duhet t'i sigurojë të shoqes një dhuratë martesë. Kjo dhuratë bëhet e drejta e saj ekskluzive dhe mbetet e tillë edhe nëse ajo më vonë divorcohet. Nusja nuk ndodhet nën asnjëlloj obligimi që t'i paraqesë çfarëdolloj dhurate burrit të saj. Për më tepër, bashkëshorti musliman është i ngarkuar me mbajtjen e të shoqes dhe fëmijëve. Gruaja, nga ana tjetër, nuk obligohet ta ndihmojë atë në këtë drejtim. Prona dhe fitesa e saj është për përdorim vetëm nga ajo, përveç nëse ajo ia ofron atë me vullnet të lirë të shoqit. Përveç kësaj, duhet të kuptohet se Islami e mbron fuqimisht jetën familjare. Ai e inkurajon me këmbëngulje rininë të martohet, dekurajon divorcin dhe nuk e konsideron beqarinë virtut. Ndaj, në një shoqëri të vërtetë islame, jeta familjare është norma dhe jeta në beqari është një përjashtim i rrallë. Kjo d.t.th se gati të gjitha gratë e moshës së martesës dhe burrat në një shoqëri islame martohen. Në dritën e këtyre fakteve, do vlerësohej fakti që burrat muslimanë, në përgjithësi, kanë barra më të mëdha financiare se gratë muslimane dhe kësaj rregullat e trashëgimisë janë nisur si barazpeshues për këtë zhbancim, me qëllim që shoqëria të jetojë e lirë nga të gjitha konfliktet e gjinive apo klasave. Pas një krahasimi të thjeshtë ndërmjet të drejtave financiare dhe detyrave të grave muslimane, një muslimane britanike arriti në përfundimin se Islami i ka trajtuar gratë jo vetëm ndershmërisht por edhe bujarisht.⁴⁷

14. BRENGA E TË VEJAVE

Ngaqë Dhiata e Vjetër nuk u njihje asnjë të drejtë trashëgimie, të vejat ishin midis më të goditurave të popullatës çifute. Të afërmit meshkuj që trashëgonin tërë pasurinë e të shoqit të saj të vdekur duhet ta mbanin atë nga ajo pasuri. Mirëpo, të vejat s'kishin asnjë mënyrë për t'u siguruar se ky veprim do kryhej dhe kështu jetonin nga mëshira e të tjerëve. Prandaj, të vejat ishin midis klasave më të ulëta në Izraelin e lashtë dhe vejueshmëria konsiderohej si simbol i një degradimi të madh (Isajah 54:4). Por fatkeqësia e një të veje në traditën biblike shtrihej madje edhe më larg se të përjashtuarit e saj nga prona e të shoqit. Sipas Zanafillës 38, një e ve pa fëmijë duhet të martohet me vëllain e të shoqit edhe nqs ky është i martuar, me qëllim që ai të prodhojë pasardhës të vëllait të vdekur, duke siguruar mosshuarjen e emrit të vëllait:

“Pastaj Juda i tha Onanit, ‘Shtrihu me të shoqen e tënd vëllai dhe plotëso detyrën tënde ndaj saj si kunat për të prodhuar pasardhës të vëllait tënd’.” (Zanafilla 38:8)

Pëlqimi [aprovimi] i të vejës për këtë martesë nuk është i nevojshëm. E veja trajtohet si pjesë e pronës së të shoqit të vdekur, funksioni kryesor i së cilës është të sigurojë pasardhës për të shoqin. Ky ligj biblik praktikohet akoma në Izraelin e sotëm.⁴⁸ Një e vejë pa fëmijë në Izrael i mbetet trashëgim vëllait të së shoqit. Nëse vëllai është tepër i ri për t'u martuar, ajo duhet të presë gjersa ai të mbushë moshën. Në rast se vëllai i bashkëshortit të vdekur refuzon të martohet me të, ajo lihet e lirë dhe atëherë mund të martohet me cilindo burrë që të zgjedhë. Nuk është një dukuri e pazakontë në Izrael që të vejat t'i nënshtrohen shantazhit nga kunetërit për të fituar lirinë e tyre.

Arabët paganë para agimit të Islamit kishin praktika të ngjashme. E veja konsiderohej pjesë e pasurisë së të shoqit që trashëgohej nga të afërmit e tij meshkuj dhe ajo zakonisht i jepej në martesë djalit më të madh të burrit të vdekur që ky kishte nga një grua tjetër. Kur'ani e sulmoi dhe e ndaloi rreptësisht këtë zakon poshtërues:

“Dhe mos u martoni me ato gra që etërit tuaj martuan - përveç atyre që tashmë e kanë bërë këtë (në të kaluarën) - (ky veprim) ishte zakoni i turpshëm, i urryer dhe vërtet i neveritshëm.” (4:22)

Të vejat dhe gratë e divorcuara shikoheshin me sy të atillë nga tradita biblike, saqë prifti i lartë s'duhet të martohet me një të vejë, një grua të divorcuar apo një prostitutë:

“Gruaja me të cilën ai (prifti i lartë) martohet duhet të jetë e virgjër. Ai nuk duhet të martohet me një të vejë, një grua të divorcuar apo një grua të përlyer nga prostitucioni, por vetëm (me) një virgjëreshë nga populli i tij që mos ta ndyjë trashëgiminë e tij në mesin e njerëzve.” (Levitiku 21:13-15)

Në Izrael sot, një pasardhës i kastit Cohen (priftërinjtë e lartë e kohëve të Tempullit) s'mund të martohet me një të divorcuar, një të vejë apo një prostitutë.⁴⁹ Në kushtetutën çifute, një grua që është bërë e vejë tre herë ndërkohë që të tre burrat e saj kanë vdekur nga shkaqe natyrore, konsiderohet 'fatale' dhe ndalohet të martohet sërish.⁵⁰ Kur'ani, nga ana tjetër, nuk njeh as kaste, as persona fatale. Të vejat dhe të divorcuarit kanë lirinë të martohen me këdo që të dëshirojnë. Divorcit apo vejueshmërisë nuk i përngjitet asnjë njollë turpi në Kur'an:

“Kur të divorconi gratë dhe ato të përmbushin afatin (tre cikle menstruacioni), ose merrini përsëri në baza të barazisë, ose lijini të lira në baza të barazisë; por mos i merrni ato sërish për t'i lënduar ose shfrytëzuar, nëse cilido e bën këtë, ai i bën padrejtësi vetë shpirtit të tij. Mos i merrni shenjat e Allahut për shaká.” (2:231)

“Nëse cilido prej jush vdes dhe lë të veja pas, ato do të presin katër muaj dhe dhjetë ditë. Kur të kenë përmbushur afatin e tyre, nuk ju vihet faj nëse ato disponohen (për martesë) në mënyrë të drejtë.” (2:234)

“Ata prej jush që vdesin dhe lënë të veja duhet të lënë për to (një sasi të hollash sa) të mbajturit e një viti dhe shtëpi. Por nëse ato ikin (nga shtëpia), nuk ju vihet faj juve për atë që ato bëjnë në mënyrë të ndershme (të drejtë) me veten e tyre.” (2:240)

15. POLIGAMIA

Le të prekim tani çështjen e rëndësishme të poligamisë. Poligamia është një praktikë tepër e lashtë që gjendet në shumë shoqëri njerëzore. Bibla nuk e dënoi poligaminë. Përkundrazi, Dhiata e Vjetër dhe shkrimet rabinike i referohen shpesh ligjshmërisë së poligamisë. Mbreti Solomon thuhet të ketë patur 700 gra dhe 300 konkubina (I Mbretërit 11:3). Gjithashtu, mbreti David thuhet të ketë patur shumë gra dhe konkubina (II Samueli 5:13). Dhiata e Vjetër përmban në të vërtetë disa udhëzime se si të ndahet pasuria e një burri ndërmjet djemve të tij nga gra të ndryshme (Deuteronomi 22:7). I vetmi kufizim për poligaminë është të ndaluarit e marrjes për grua rivale motrën e bashkëshortes (Levitiku 18:18). Talmudi këshillon një maksimum prej katër grashë.⁵¹ Çifutët evropianë vazhduan ta praktikojnë poligaminë deri në shekullin e 16-të. Çifutët orientalë e praktikuan rregullisht poligaminë gjersa mbërritën në Izrael ku ajo ndalohet nën ligjin civil. Mirëpo, nën ligjin fetar i cili e tejkalon ligjin civil në raste të tilla, ajo lejohet.⁵²

Po Dhiata e Re ç' thotë? Sipas At Eugene Hillman në librin e tij të mprehtë *Poligamia e Risbqyrtuar*, "Askund në Dhiatën e Re nuk ka as edhe një urdhëresë eksplicite që martesat duhet të jetë monogame, apo çfarëdoj urdhërese të hapur që ndalon poligaminë."⁵³ Përveç kësaj, Jezusi (a.s) s'ka folur kurrë kundër poligamisë megjithëse ajo praktikohet nga çifutët e shoqërisë së tij. At Hillman thekson faktin se Kisha në Romë e ndaloi poligaminë me qëllim që t'i vinte përshtat kulturës greko-romake (e cila parashtronte vetëm një grua të ligjshme, ndërkohë që toleronte bashkëjetesën dhe prostitucionin). Ai citon Shën Agustinin, **"E vërteta është se tani në kohën tonë, duke ruajtur dhe vazhduar zakonet romak, marrja e një bashkëshorteje tjetër nuk lejohet më."**⁵⁴ Kishat afrikane dhe të krishterët afrikanë ua kujtojnë shpesh vëllezërve të tyre evropianë se ndalimi i poligamisë nga Kisha është një traditë kulturore dhe jo një udhëzim autentik kristian.

Kur'ani gjithashtu, e lejoi poligaminë, por jo pa kufizime:

"Në qoftë se druani se nuk do të (jeni në gjendje) të jeni të drejtë ndaj jetimëve, (atëherë) martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri, ose katër, por nëse frikësoheni se s'do jeni (në gjendje të jeni) të drejtë me to, atëherë vetëm me një."
(4:3)

Kur'ani, ndryshe nga Bibla, vuri [si] kufi një maksimum prej katër grash nën kushtin e rreptë të të trajtuarit njëjloj dhe drejtësisht të tyre. Nuk duhet menduar se Kur'ani i nxit besimtarët të praktikojnë poligami, apo se poligamia konsiderohet si një ideal. Me fjalë të tjera, Kur'ani e ka toleruar apo lejuar poligaminë, dhe vetëm kaq; por përse vallë? Pse është poligamia e lejueshme dhe e pranueshme? Përgjigja është e thjeshtë: ka vende dhe kohëra në të cilat ekzistojnë arsye detyruese për poligaminë. Siç tregon vargu i mësipërm kur'anor, çështja e poligamisë në Islam nuk mund të kuptohet ndaras nga detyrimet e bashkësisë ndaj jetimëve dhe të vejave. Islami si një fe universale e përshtatshme për të gjitha vendet dhe për të gjitha kohërat, s'mund t'i shpërfillë këto arsye detyruese.

Në shumicën e shoqërive njerëzore, femrat i kalojnë për nga numri meshkujt. Në Sh.B. ka* [*1994, sh.p.] të paktën tetë milion gra më shumë se burra. Në një vend si Guinea ka 122 femra për çdo 100 meshkuj. Në Tanzani ka 95 meshkuj për 100 femra.⁵⁵ Ç’duhet të ndërmerri një shoqëri ndaj raporteve kaq të zbalancuara ndërmjet gjinive? Ekzistojnë zgjidhje të ndryshme; disa mund të sugjerojnë beqarinë, disa do preferonin infanticidin femëror (i cili ndodh me të vërtetë në disa shoqëri në botë sot!). Të tjerë mendojnë se e vetmja rrugëdalje është që shoqëria duhet të tolerojë të gjitha mënyrat e dekadencës morale: prostitucionin, seksin jashtë kurorës, homoseksualizmin.. etj. Shoqëri të tjera (si shumica e shoqërive afrikane sot) do të shihnin si rrugëdaljen më të nderuar martesën poligame - si një institucion të pranuar nga ana kulturore dhe të respektuar nga ana shoqërore. Ajo që keqkuptohet shpesh në Perëndim është se gratë në kulturat e tjera nuk e shohin poligaminë medoemos si simbol të degradimit të grave. Për shembull, shumë gra të reja afrikane (qofshin të krishtera, muslimane, apo ndryshe) do preferonin të martoheshin me një burrë të martuar që e ka treguar veten një bashkëshort të përgjegjshëm. Shumë gra afrikane i nxisin burrat e tyre të gjejnë edhe një grua që të mos ndjehen të vetmuar.⁵⁶ Një anketë me mbi gjashtë mijë gra, nga moshë 15 deri 59 vjeç, e kryer në qytetin e dytë më të madh të Nigerisë, tregoi se 60 % e këtyre grave do ishin të kënaqura nëse burrat e tyre do të merrnin një grua tjetër. Vetëm 23% shprehën mosaprovim ndaj idesë së të ndarit [të burrit] me një grua tjetër. 76% e grave në një anketë të kryer në Kenia e shikonin pozitivisht poligaminë. Në një anketim të ndërmarrë në Kenian rurale, 25 nga 27 gra e konsideronin poligaminë më të mirë se monogaminë. Këto gra ishin të mendimit se poligamia mund të jetë një përvojë e gëzueshme dhe përfituese nëse gratë në fjalë bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.⁵⁷ Poligamia në shumicën e shoqërive afrikane është një institucion aq i respektueshëm sa që disa kisha protestante po bëhen gjithnjë e më tolerante ndaj saj. Një peshkop i kishës anglikane në Kenia deklaroi se, “Megjithëse monogamia mund të jetë ideali për shprehjen e dashurisë midis burrit dhe gruas, Kisha duhet të marrë parasysh se në kultura të caktuara poligjinia është shoqërisht e pranueshme dhe se bindja se poligjinia është kundër [parimeve të] Krishtërit, nuk qëndron më.”⁵⁸ Pas një studimi të kujdesshëm të poligamisë në Afrikë, Hirësia e tij David Gitari i kishës anglikane arriti në përfundimin se poligamia, siç praktikohet në rastin ideal, është më kristiane se divorci dhe të martuarit sërish përse i përket gruas dhe fëmijëve të braktisur.⁵⁹ Unë personalisht njoh disa bashkëshorte shumë të arsimuara që, edhe pse kanë jetuar në Perëndim për shumë vite, nuk kanë asnjë vërejtje kundër poligamisë. Njëra prej tyre, që jeton në Sh.B., e nxit solemnisht të shoqin për të marrë një grua të dytë që t’i ndihmojë asaj të rrisë fëmijët.

Problemi i raporteve të zbalancuara midis gjinive bëhet me të vërtetë problematik në kohë lufte. Fiset indiane vendase të Amerikës vuanin nga raporte tepër të çekuilibruara midis sekseve pas humbjes së luftës. Gratë e këtyre fiseve, të cilat ç’është e vërteta gëzonin një status mjaft të lartë, e pranonin poligaminë si mbrojtja më e mirë kundër pjesëmarrjes në aktivitete të pahijshme. Kolonizatorët evropianë, dike mos ofruar asnjë alternativë tjetër, e dënuan këtë poligami indiane si ‘të paqytetëruar’.⁶⁰ Pas luftës së dytë botërore, në Gjermani kishte 7 300 000 gra më shumë se burra (3.3 milion prej tyre ishin të veja). Kishte 100 burra të moshës 20 deri 30 vjeç për çdo 167 gra të kësaj grupmoshe.⁶¹ Shumë nga këto gra kishin nevojë për një burrë jo vetëm si shok jete por gjithashtu edhe si sigures i mirëqenies së shtëpisë në një kohë mjerimi dhe halli të paparë. Ushtarët e Forcave fitimtare Aleate e shfrytëzuan këtë dobësi të grave. Shumë vajza të reja dhe të veja kishin lidhje me pjesëtarë të forcave pushtuese. Shumë ushtarë amerikanë dhe britanikë paguanin për kënaqësitë e

tyre në cigare, çokollata dhe bukë. Fëmijët ishin tepër të lumtur nga dhuratat që sillnin këta të huaj. Një djalë 10 vjeçar duke dëgjuar nga fëmijë të tjerë për dhurata të tilla uronte nga zemra për një 'anglez' për të ëmën, në mënyrë që ajo të mos rrinte më e uritur.⁶² Duhet të pyesim vetë ndërgjegjen tonë në këtë pikë: Çfarë është më e denjë për një grua? Një grua e dytë e pranuar dhe e respektuar, si në trajtimin e indianëve vendas, apo gati një prostitutë si në trajtimin e Aleatëve 'të qytetëruar'? Me fjalë të tjera, ç'është më nderuese për gruan: parashtrimi kur'anor apo teologjia e bazuar në kulturën e Perandorisë romake?!

Është interesante të vërehet se në një mbledhje ndërkombëtare të rinisë, të mbajtur në Mynih më 1948 u diskutua problemi i raportit tejet të çekuilibruar midis gjinive në Gjermani. Kur u bë e qartë se nuk mund të bëhej dakord mbi asnjë zgjidhje, disa pjesëmarrës sugjeruan poligaminë. Reagimi fillestar i të mbledhurve ishte një përzierje tronditjeje dhe neveritjeje. Megjithatë, pas një studimi të kujdesshëm të propozimit, pjesëmarrësit ranë dakord se ajo ishte zgjidhja e vetme e mundshme. Si rrjedhojë, poligamia u përfshi ndërmjet rekomandimeve përfundimtare të konferencës.

Bota sot zotëron më shumë armë të shkatërrimit në masë se kurrë më parë dhe kishat evropiane herët a vonë mund të detyrohen të pranojnë poligaminë si e vetmja rrugëdalje. At Hillman e ka dalluar plot mprehtësi këtë fakt: "Është mjaft e kuptueshme që këto teknika gjenocidi (bërthamore, biologjike, kimike...) mund të prodhojnë një zhbilancim aq drastik ndërmjet gjinive sa që martesat plurale do bëhej një mjet i domosdoshëm mbijetimi... Atëherë, në kundërshtim me zakonet dhe ligjin e mëparshëm, një anim i natyrshëm dhe moral mbizotërues mund të lindë në favor të poligamisë. Në një situatë të tillë, teologët dhe drejtuesit kishtarë do nxirrnin shpejt e shpejt arsye me peshë dhe tekste biblike për të justifikuar një koncept të ri të martesës."⁶⁴

Edhe sot e kësaj dite, poligamia vazhdon të jetë një zgjidhje e vlefshme për disa sëmundje sociale të shoqërive moderne. Detyrimet bashkësore që Kur'ani përmend lidhur me lejimin e poligamisë janë më të mprehta dhe më të qarta tashmë në disa shoqëri perëndimore sesa në Afrikë. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara sot, ka një krizë të rëndë gjinish në komunitetin e zi. Një në çdo njëzet të ri zezakë meshkuj mund të vdesi para se të arrijë moshën 21 vjeçare. Për ata midis 20 dhe 35 vjetëve, vrasja është shkaku kryesor i vdekjes.⁶⁵ Përveç kësaj, shumë të rinj meshkuj janë të papunë, në burg ose të droguar.⁶⁶ Si rezultat, një ndër katër gra zezake në moshën 40 vjeçare, nuk është martuar asnjëherë, në krahasim me një ndër dhjetë tek gratë e bardha.⁶⁷ Për më tepër, shumë femra të reja zezake bëhen nëna beqare para se të mbushin 20 vjeç dhe e shohin veten në nevojë për mbështetës. Rezultati përfundimtar i këtyre rrethanave tragjike është se një numër gjithnjë e në rritje grashë zezake përfshihet në atë që quhet 'ndarje e burrit'.⁶⁸ Kjo d.t.th. se shumë nga këto gra të pashpresa beqare përfshihen në afera me burra të martuar. Gratë janë shpesh të pavetdijshme për faktin se gra të tjera po 'ndajnë' me to bashkëshortët e tyre. Disa vëzhgues të krizës së ndarjes së burrit në bashkësinë Afro-Amerikane këshillojnë fuqimisht poligami konsensuale si një përgjigje të përkohshme ndaj mungesës së meshkujve zezakë deri sa reforma më të arsyeshme të ndërmerren në shoqërinë amerikane.⁶⁹ Me poligami konsensuale ata nënkuptojnë një poligami që miratohet nga bashkësia dhe me të cilën kanë rënë dakord të gjitha palët në fjalë, në kundërshtim me të ndarit zakonisht sekret të burrit që është i dëmshëm si për gruan ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Problemi i ndarjes së burrit në bashkësinë Afro-Amerikane ishte tema e një diskutimi panelitik të mbajtur në

Temple University të Philadelphia-s më 27 Janar 1993.⁷⁰ Disa nga ligjëruesit rekomanduan poligaminë si një zgjidhje potenciale për krizën. Ata gjithashtu sugjeruan që poligamia nuk duhet dënuar me ligj, sidomos në një shoqëri që toleron prostitucionin dhe dashnoret. Komenti i një gruaje nga auditori se afro-amerikanët duhet të mësojnë nga Afrika ku poligamia praktikohet me përgjegjësi, korri aplaudim entuziast. Philip Kilbride, një antropolog amerikan i një prejardhjeje katolike romake, në librin e tij provokativ *Martesa Plurale për Kobën Tonë*, propozon poligaminë si zgjidhje për disa sëmundje në masë të shoqërisë amerikane. Ai argumenton se martesë plurale mund të shërbejë si një alternativë potenciale për divorcin në shumë raste me qëllim që të shmangë ndikimin dëmtues të divorcit mbi shumë fëmijë. Ai pohon se shumë divorce shkaktohen nga aferat e shfrenuara jashtëmartesore në shoqërinë amerikane. Sipas Kilbride, të dhënit fund një afere jashtëmartesore në martesë poligame në vend që në divorc, është më e mirë për fëmijët: “Fëmijëve do u shërbejë më tepër nëse rritja e familjes - në vend të ndarjes dhe shpërbërjes - të shikoheshin si variante.” Për më tepër, ai sugjeron që grupe të tjera do të përfitojnë gjithashtu nga martesë plurale si: gratë e vjetra që përballojnë një mungesë kronike të burrave dhe Afro-Amerikanet që janë të përfshira në ndarjen e burrit.⁷¹

Më 1987, një anketë e kryer nga gazeta studentore në Universitetin e Kalifornias në Berkeley i pyeti studentët nëse ata ishin dakord që burrat duhet të lejohen me ligj të kenë më shumë se një grua në përgjigje të një mungese të dukshme të kandidatëve meshkuj për martesë në Kaliforni. Gati të gjithë studentët e pyetur e aprovuan idenë. Një studente madje pohoi se një martesë poligame do të përmbushte nevojat e saja emocionale dhe fizike duke i dhënë liri më të madhe sesa një lidhje monogame.⁷² Në fakt, i njëjti argument përdoret gjithashtu nga të paktat gra fundamentaliste mormone të mbetura, të cilat e praktikojnë akoma poligaminë në Sh.B. Ata besojnë se poligamia është një ideal për një grua që ajo të ketë si karrierë ashtu edhe fëmijë, ngaqë gratë i ndihmojnë njëra-tjetrës të kujdesen për fëmijët.⁷³

Duhet shtuar gjithashtu se poligamia në Islam është çështje marrëveshjeje të ndërsjelljtë. Asnjëri s'mund ta detyrojë një grua të martohet me *asnjë* burrë e aq më pak me një të martuar. Përveç kësaj, gruaja ka të drejtë të vendosë kushtin që burri i saj s'mund të martohet me cilëndo grua tjetër si bashkëshorte të dytë.⁷⁴ Bibla, nga ana tjetër, nganjëherë i drejtohet poligamisë së detyruar. Një e ve pa fëmijë duhet sesbën të martohet me vëllain e të shoqit, edhe pse ky është i martuar, (shiko kaptinën *Brenga e të Vejave*) pavarësisht nga pëlqimi i saj (Gjeneza 38:8-10).

Duhet mbajtur parasysh se në shumë shoqëri muslimane sot, të praktikuarit e poligamisë është i rrallë ngaqë hendeku midis numrit të dy gjinive s'është i madh. Mund të thuhet pa frikë se shkalla e martesave poligame në botën muslimane është mesiguri shumë më e ulët se shkalla e marrëdhënieve jashtëmartesore në Perëndim. Me fjalë të tjera, burrat në botën muslimane sot janë tejet më shumë rreptësisht monogamë se burrat në botën perëndimore!

Billy Graham, evangjelisti eminent kristian e ka njohur këtë fakt haptazi: “Krishtërimi nuk mund të bëjë kompromis në çështjen e poligamisë. Nëse Krishtërimi i sotëm s'mund ta bëjë këtë, kjo s'është veçse në dëm të tij. Islami e ka lejuar poligaminë si një zgjidhje për sëmundjet shoqërore dhe ka lejuar një shkallë të caktuar tolerance ndaj natyrës njerëzore

por vetëm përbrenda suazës së rreptëpërcaktuar të ligjit. Vendet kristiane mburren shumë me monogaminë, por në të vërtetë ato praktikojnë poligaminë. Askush s'është i pandërgjegjshëm për rolin që dashnoret luajnë në shoqërinë perëndimore. Në këtë aspekt Islami është një fe thelbësisht e ndershme, dhe i lejon një muslimani të martohet me një grua të dytë nëse atij i duhet patjetër, por ndalon rreptësisht çdo lidhje klandestine amatore me qëllim ruajtjen e ndershmërisë morale të bashkësisë.⁷⁵

Është interesante të theksohet se shumë vende, jo-muslimane apo muslimane në botë sot e kanë nxjerrë jashtë ligjit poligaminë. Të marrurit e një gruaje të dytë, edhe me lejimin e lirë të gruas së parë, është shkelje ligji. Nga ana tjetër, të tradhëtuarit e gruas, pa dijeninë e as lejen e saj, është përsosmërisht legjitime përsa i përket ligjit. Cila është urtia ligjore që qëndron pas një kundërshtie të tillë? A është përpiluar ligji për të shpërblyer mashtrimin dhe dënuar ndershmërinë? Ky është një ndër paradokset absurde të botës sonë moderne 'të qytetëruar'.

16. MBULESA

Më në fund, le të hedhim ca dritë mbi atë që në Perëndim mbahet si simboli më i madh i shtypjes dhe i pozicionit të nënshtruar të gruas - shamia ose mbulesa e kokës. A është e vërtetë se diçka e tillë si mbulesa nuk ekziston në traditën Judeo-Kristiane? Le t'i shtrojmë faktet drejt.

Sipas Rabin Dr. Menachem M. Brayer (Profesor i Literaturës Biblike në Universitetin Yeshiva) në librin e tij *Gratë Çifute në Literaturën Rabinike*, ishte zakon që gratë çifute të dilnin jashtë të mbështjellura me mbulesë të kokës e cila nganjëherë mbulonte madje gjithë fytyrën duke lënë jashtë vetëm një sy të lirë.⁷⁶ Ai citon disa rabinë të famshëm të kohërave të shkuara që thonin: **“Nuk u ka hije bijave të Izraelit të dalin jashtë me kokat e zbuluara. I mallkuar qoftë burri që lejon të shihen flokët e së shoqes... Një grua që ekspozon flokët e saj për vetë-adhurim sjell varfëri.”** Ligji rabinik e ndalon rreptësisht recitimin e bekimeve ose lutjeve në praninë e një gruaje të martuar kokëzbuluar, ngaqë të zbuluarit e flokëve të gruas konsiderohet ‘lakuriqësi’.⁷⁷ Dr. Brayer përmend gjithashtu se **“Gjatë periudhës tanaitike, të mosmbuluarit e kokës nga ana e gruas konsiderohej fyerje e modestisë së saj. Kur koka e saj ishte e zbuluar ajo gjobitej deri në katërqind zuzime për këtë shkelje.”** Dr. Brayer gjithashtu shpjegon se mbulesa e gruas çifute nuk konsiderohej gjithmonë shenjë modestie. Nganjëherë, shamia simbolizonte një gjëndje dallimi dhe luksi në vend të modestisë. Mbulesa personifikonte dinjitetin dhe epërsinë e gruas fisnike. Ajo gjithashtu përfaqësonte mosmundësinë e të afruarit një gruaje si pronë e shenjtëruar e të shoqit.⁷⁸

Është e qartë se në Dhiatën e Vjetër të zbuluarit e kokës së gruas përbënte paturpësi të madhe dhe kjo është arsyeja që kleriku duhej ta zbulonte adulteristen e dyshuar në gjyqin e saj të provës së rëndë. (Numrat 5:16-18)

Shamia nënkuptonte vetë-respektin dhe statusin shoqëror të gruas. Gratë e klasave të ulëta shpesh vishnin shaminë për të dhënë përshtypjen e një rangu më të lartë. Fakti se shamia ishte shenja e fisnikërisë, përbënte arsyen pse prostitutave nuk u lejohej të mbulonin flokët në shoqëritë e vjetra çifute. Megjithatë, prostitutat shpesh vinin një mbulesë koke për t'u dukur të respektueshme.⁷⁹ Gratë çifute në Evropë vazhduan t'i vishnin shamitë deri në shekullin e XIX, kur jetët e tyre u bënë më të përziera me kulturën sekulare rrethuese. Trysni të jashtme të jetës evropiane në shekullin e XIX i detyruan shumë nga ato të dalin jashtë kokëzbuluar. Disa gra çifute e panë më të volitshme të zëvendësojnë shaminë e tyre tradicionale me një paruke si një formë tjetër e të mbuluarit të flokëve. Sot, shumica e grave fetare çifute nuk i mbulojnë flokët e tyre, përveçse në sinagogë.⁸⁰ Disa nga ato, si p.sh. sektet Hasidike, ende përdorin paruken.⁸¹

Po për traditën e krishterë? Dihet mirë që Murgeshat katolike i mbulojnë kokat e tyre që prej qindra vjetësh, por kjo s'është e gjitha. Shën Pali në Dhiatën e Re ka bërë disa pohime shumë interesante për shaminë:

“Tani unë dua që ju të kuptoni se koka e çdo burri është Krishti, dhe koka e çdo gruaje është burri, dhe koka e Krishtit është Zoti. Çdo njeri që lutet apo predikon me kokë të mbuluar çnderon kokën e tij. Dhe çdo grua që lutet apo predikon me kokë të zbuluar çnderon kokën e saj - është tamam sikur koka e saj të jetë e rruar. Nëse një grua s’e mbulon kokën e saj, asaj duhet t’i priten flokët; dhe nëse është turp për një grua t’i ketë flokët e qethura ose të rruara, ajo duhet ta mbulojë kokën. Një burrë s’duhet ta mbulojë kokën e tij, ngaqë ai është shëmbëllimi dhe lavdia e Zotit, por gruaja është lavdia e burrit. Sepse nuk erdhi burri nga gruaja, por gruaja nga burri dhe as burri s’u krijua për gruan, po gruaja për burrin. Për këtë arsye dhe për shkak të ëndëgjësive, gruaja duhet të ketë një shenjë autoriteti mbi kokë.” (I Korinthiasit 11:3-10)

Arsyetimi i Shën Palit për gratë e mbuluara është se mbulesa përfaqëson një shenjë autoriteti të burrit - që është shëmbëllimi dhe lavdia e Zotit – mbi gruan, që u krijua prej dhe për burrin. Shën Tertuliani në traktatin e tij të njohur *Mbi Mbulimin e Virgjërëshave*, shkruante: **“Gra të reja, t’i vishni shamitë jashtë në rrugë, po kështu t’i vishni në kishë, t’i vishni kur jeni mes të huajve, pastaj t’i vishni midis vëllezërve tuaj..”** Midis ligjeve kanunore të Kishës Katolike sot, ekziston një ligj që kërkon patjetër nga gratë që t’i mbulojnë medoemos kokat kur hyjnë në Kishë.⁸² Diza degëzime kristiane, siç janë ato të amishëve dhe memonitëve për shembull, vazhdojnë t’i mbajnë gratë të mbuluara gjer më sot e kësaj dite. Arsyetimi për mbulesën që ofrohet nga udhëheqësit e tyre të Kishës, është se **“mbulesa e kokës përmban simbol të nënshtrimit të gruas ndaj burrit dhe Zotit.”** E njëjta logjikë paraqitet nga Shën Pali në Dhiatën e Re.⁸³

Nga të gjitha faktet e mësipërme, është e qartë se nuk e shpiku Islami mbulesën e kokës. Megjithatë, Islami e konfirmoi atë. Kur’ani i urdhëron burrat dhe gratë besimtare të ulin shikimin ngulmues dhe të ruajnë modestinë e tyre, e pastaj i urdhëron gratë besimtare t’i zgjasin mbulesat e tyre deri tek duart dhe kraharori:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet dhe të ruajnë modestinë e tyre ... thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë bukurinë dhe stilitë e tyre, përveç atyre (stolive) që janë (gjithsesi) të dukshme; le të vënë shamitë mbi kraharorët e tyre.” (24:30-31)

Kur’ani është tepër i qartë [në të treguarit] se mbulesa është pjesë kyç e një recete të krijuar për qëllimet e modestisë, po përse vallë modestisë? Kur’ani është përsëri i qartë:

“O’ Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua, dhe grave të besimtarëve, le të vënë shamitë e veta mbi trupat e tyre, që të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen (a cënohen).” (33:59)

Kjo është e gjithë çështja, modestia është parashtruar që të mbrojtë gratë nga ofendimet, apo thjesht - modestia është mbrojtje. Kështu, qëllimi i vetëm i mbulesës në Islam është mbrojtja. Mbulesa Islame, në ndryshim nga ajo e traditës së krishterë, nuk është shenjë e autoritetit të burrit mbi gruan dhe as shenjë e nënshtimit të saj ndaj tij. Mbulesa islame, në ndryshim nga tradita çifute, nuk është shenjë luksi dhe dallimi për disa gra të martuara të fisme. Mbulesa islame është vetëm shenjë modestie për arsyen e vetme të mbrojturit të grave - të gjitha grave. Filozofia islame qëndron në atë se është gjithmonë më mirë të jesh e sigurtë sesa e vajtueshme. Ç'është e vërteta, Kur'ani kështu interesohet për të mbrojtur trupat e grave dhe reputacionin e tyre, saqë një burrë që guxon të akuzojë pa të drejtë një grua për pandershmëri, do të dënohet rreptësisht:

“Dhe ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, rrahini me nga tetëdhjetë goditje dhe atyre mos ua pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm.” (24:4)

Krahasojeni këtë qëndrim të rreptë të Kur'anit me dënimin jashtëzakonisht të lehtë për përdhunim në Bibël:

“Nëse një burrë ndodh të takojë një virgjëreshë që s'është dakord të martohet (me të) dhe e përdhunon atë e ata zbulohen, ai duhet t'i paguajë babait të vajzës pesëdhjetë shekele argjendi. Ai duhet të martohet me vajzën, sepse ai e ka dhunuar atë. Ai s'mund ta divorcojë atë për sa (kohë ai) të jetë gjallë.” (Deuteronomi 22:28-30)

Këtu duhet bërë një pyetje e thjeshtë: kush u dënua në të vërtetë? Burri që vetëm pagoi një gjobë për përdhunimin, apo vajza që detyrohet me forcë të martohet me njeriun që e përdhunoi atë dhe të jetojë me pahir me të gjersa ai të vdesë? Një tjetër pyetje që duhet bërë është: ç'është më mbrojtëse për gratë, qëndrimi i rreptë kur'anor, apo qëndrimi i vokët biblik?

Disa njerëz, sidomos në Perëndim, do përpiqeshin ta përçeshnin argumentin e modestisë për [qëllim] mbrojtjeje. Argumenti i tyre është se mbrojtja më e mirë është përhapja e edukimit, sjelljes së qytetëruar dhe vetëpërmbytjes. Ne do thonim: në rregull, por jo e mjaftueshme. Nëse 'qytetërimi' mjafton për mbrojtje [të grave] atëherë përse gratë në Amerikën e Veriut s'guxojnë të ecin vetëm në një rrugë të errët, madje as përgjatë një vendparkingu të zbrazët? Nëse arsimimi është zgjidhja, atëherë përse një universitet si i Queen's ka një 'walk home service' për studentet në qytezën studentore? Nëse 'vetëpërmbytja' është përgjigja, atëherë përse vetëm në Sh.B. ndodh një përdhunim në çdo 12 minuta;⁸⁴ përse janë rastet e bezdisjes seksuale në vendin e punës në lajmet e mediave çdo ditë? Një përmbledhje e të akuzuarve për sulme seksuale në këto pak vitet e fundit përfshin oficerë marine, menaxherë, profesorë universitetesh, senatorë, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe Presidentin e Shteteve të Bashkuara! Unë s'mund t'i besojë syve kur lexova statistikën e mëposhtme, të shkruara në një pamflet të nxjerrë nga Dekani i Zyrës së Grave në Queen's University:

- në Kanada, një grua sulmohet seksualisht çdo 6 minuta,
- 1 ndër 3 gra në Kanada do sulmohet seksualisht në një kohë të jetës së saj
- 1 ndër 4 gra janë në rrezik të përdhunimit ose përpjekjes së përdhunimit gjatë jetës së tyre
- 1 ndër 8 gra do të sulmohet seksualisht gjatë ndjekjes së kolegjit ose universitetit dhe
- një studim zbuloi se 60% e meshkujve në moshë universitare thanë se do të kryenin lirshëm sulmim seksual po të ishin të sigurt se nuk do kapeshin!

Diçka është e gabuar në thelb në shoqërinë ku jetojmë. Një ndryshim rrënjësor në mënyrën e jetesës të shoqërisë dhe kulturës është absolutisht i nevojshëm. Një kulturë modestie nevojitet dëshpërueshëm; modesti në veshje, të folur dhe në sjelljet e burrave dhe grave. Pëndryshe statistikatat e errëta do rriten edhe më keq ditë pas dite e, për fat të keq, vetëm gratë do paguajnë çmimin. Ç’është e vërteta, ne të gjithë do vuajmë, por siç ka thënë Khalil Gibran “...nuk është njëllor për personin që kamxhikët i pëson si për të që ato i numëron.”⁸⁵ Prandaj, një shoqëri si Franca që përjashton vajzat e reja nga shkolla për shkak të veshjes së tyre modeste, në fund të fundit, thjesht dëmton veten.

Është ndër ironitë e mëdha të botës sonë moderne sot se krejtësisht e njëjta mbulesë koke së cilës i tregohet respekt si shenjë ‘shenjtërie’ kur vishet për qëllimin e të treguarit të autoritetit të burrit nga murgeshat katolike, shahet rëndazi si një shenjë ‘shtypjeje’ kur vishet për qëllimin e mbrojtjes nga gratë muslimane.

17. EPILOG

Pyetja e përbashkët që të gjithë jo-muslimanët të cilët lexuan një version të mëparshëm të këtij studimi ishte: a marrin gratë muslimane në botën muslimane sot trajtimin fisnik të përshkruar këtu? Përgjigja, për fat të keq, është: Jo. Meqë kjo pyetje është e pashmangshme në çdo diskutim që ka të bëjë me statusin e gruas në Islam, duhet të shtjellojmë më tej mbi përgjigjen për t'i siguruar lexuesit pamjen e plotë.

Duhet bërë e qartë së pari se ndryshimi i madh midis shoqërive muslimane e bën shumicën e përgjithësimeve tepër thjeshtuese. Ka një spektër të gjërë qëndrimesh ndaj grave në botën muslimane sot; këto qëndrime ndryshojnë nga njëra shoqëri në tjetrën dhe përbrenda çdo shoqërie të veçantë. Prapëseprapë, prirje të përgjithshme të caktuara janë të dallueshme. Gati të gjitha shoqëritë muslimane kanë - në një shkallë apo një tjetër - devijuar nga idealet e Islamit lidhur me statusin e grave. Këto devijime kanë qenë, në pjesën dërrmuese, në njërin prej dy drejtimeve të kundërta. Drejtimi i parë është më konservativ, shtrëngues dhe i orientuar nga traditat, ndërsa i dyti është më liberal dhe i orientuar nga Perëndimi.

Shoqëritë që janë shmangur në drejtimin e parë i trajtojnë gratë sipas zakoneve dhe traditave të trashëguara nga paraardhësit e tyre. Këto tradita zakonisht i deprivojnë gratë nga shumë të drejta që u janë dhuruar atyre nga Islami. Përveç kësaj, gratë trajtohen sipas standardesh krejtësisht të ndryshme nga ato me të cilat trajtohen burrat. Ky diskriminim përshkon [gjithë] jetën e çdo femre: ajo pritet me më pak gëzim kur lind sesa një djalë; ajo ka më pak gjasje të shkojë në shkollë; ajo mund të deprivohet nga çfarëdo pjesë në trashëgiminë e familjes së saj; ajo ndodhet nën mbikqyrje të vazhduar me qëllim që të mos silllet pahijshëm, ndërkohë që veprimet e pahijshme të të vëllait tolerohen - ajo madje mund të vritet se ka kryer diçka për të cilën pjesëtarët meshkuj të familjes së saj zakonisht krekosen që e bëjnë; ajo ka shumë pak ndikim në çështjet e familjes apo interesat e bashkësisë; ajo mund të mos ketë kontroll të plotë mbi pronën e saj dhe dhuratat martesore që ka marrë; dhe së fundi si nënë ajo vetë do preferonte të dhuronte djem për të arritur një status më të lartë në bashkësinë e vet.

Nga ana tjetër, ka shoqëri muslimane (apo klasa të caktuara përbrenda disa shoqërive) që janë fshirë mënjanë nga kultura dhe mënyra e jetesës perëndimore. Këto shoqëri shpesh imitojnë pa menduar çfarëdo që marrin nga Perëndimi dhe zakonisht përfundojnë duke përvetësuar frytet më të këqija të qytetërimit perëndimor. Në këto shoqëri, përparësia kryesore e një gruaje tipike "moderne" është t'ia ngrisë vlerën bukurisë së saj fizike. Prandaj, ajo është vazhdimisht e obsesionuar me formën e trupit, përmasat dhe peshën e saj. Ajo pritet të shqetësohet më shumë për trupin e saj sesa mendjen dhe më tepër për pamjen joshëse të saj sesa për intelektin. Aftësia e saj për të joshur, tërhequr dhe eksituar vlerësohet më shumë në shoqërinë ku jeton sesa arritjet e saj arsimore, përparimet intelektuale dhe puna në shoqëri. Nuk pritet të gjetet një kopje e Kur'anit në çantën e saj sepse është plot me prodhime kozmetike të cilat e shoqërojnë atë kudo që shkon. Përshpirtshmëria e saj nuk ka vend në një shoqëri të preokupuar me tërheqshmërinë e saj.

Prandaj, asaj do i pëlqente ta kalonte jetën duke u përpjekur më shumë për të vënë në pah feminilitetin e saj sesa për të përmbushur njerzshmërinë e saj.

Përse devijuan muslimanët nga idealet e Islamit? Nuk ka një përgjigje të lehtë. Një shpjegim depërtues i arsyeve përse muslimanët nuk kanë ndjekur me vendosmëri dhe patundshëm drejtimin kur'anor lidhur me gratë do ishte përtej qëllimit të këtij studimi. Duhet bërë e qartë, megjithatë, se shoqëritë muslimane kanë devijuar nga udhëzimet islame lidhur me aq shumë aspekte të jetëve të tyre për kaq gjatë. Ka një hendek të gjerë ndërmjet asaj në të cilën muslimanët duhet të besojnë dhe asaj që bëjnë në praktikë në të vërtetë. Ky hendek nuk është një dukuri e sotshme. Ai ka qenë i pranishëm me shekuj dhe po zgjerohet nga dita në ditë. Ky hendek gjithnjë e më i gjerë ka patur pasoja shkatërrimtare mbi botën muslimane në gati të gjitha aspektet e jetës: tirani dhe fragmentim politik, prapambetje ekonomike, padrejtësi sociale, falimentim të shkencës, vendqendrim intelektual, etj. Statusi jo-islam i grave në botën muslimane sot është thjesht një simptomë e një sëmundjeje më të thellë. Cilado reformë në statusin e tanishëm të grave muslimane nuk pritet të jetë e frytshme nëse nuk shoqërohet nga reforma më kuptimplote të krejt mënyrës së jetesës së shoqërive muslimane. Botës muslimane i nevojitet një rilindje që do e sjellë atë më pranë idealeve të Islamit, e jo më larg. Për ta përmbledhur, mendimi se statusi i varfër i grave muslimane sot në botë është për shkak të Islamit, përbën një keqkonceptim të skajshëm. Problemet e muslimanëve në përgjithësi s'janë për arsye të lidhjes së tepruar me Islamin, ato janë kulminimi i një shkëputjeje të gjatë dhe të thellë prej tij.

Duhet ritheksuar, gjithashtu, se qëllimi pas këtij studimi krahasues nuk është në asnjë mënyrë të shahet Judaizmi apo Krishterimi. Pozicioni i grave në traditën judeo-kristiane mund të duket i frikshëm nga standardet tona të fundshekullit të njëzetë. Megjithëkëtë, ai duhet vështruar brenda kontekstit të duhur historik. Me fjalë të tjera, çdo vlerësim objektiv i pozicionit të grave në traditën judeo-kristiane duhet të marrë parasysh rrethanat historike nën të cilat kjo traditë u zhvillua. S'mund të ketë asnjë dyshim se pikëpamjet e Rabinëve dhe Etërve kishtarë lidhur me gratë u ndikuan nga qëndrimet mbizotëruese ndaj grave në shoqëritë e tyre. Vetë Bibla u shkrua nga autorë të ndryshëm në kohëra të ndryshme. Këta autorë s'mund të kenë qenë të padepërtueshëm nga vlerat dhe mënyra e jetesës së njerëzve rreth tyre. Për shembull, ligjet e adulterisë së Dhiatës së Vjetër janë aq të anshme kundër grave, saqë ato sfidojnë një shpjegim racional nga mentaliteti ynë. Megjithatë, nëse marrim parasysh faktin se fiset e hershme çifute ishin të obsesionuara me homogjenitetin e tyre gjenetik dhe skajimisht këmbëngulës për ta përkufizuar vetveten anash fiseve rrethuese, dhe se vetëm shkeljet seksuale të femrave të martuara të fiseve mund t'i kërcënonin këto aspirata të ushqyera, ne atëherë mund të ishim në gjendje të kuptonim - por jo medoemos të simpatizonim me - arsyet e kësaj anshmërie. Gjithashtu, kritikën e ashpra e të idhëta të Etërve kishtarë kundër grave s'duhet të shkëputen nga konteksti i kulturës misogyniste greko-romake në të cilën ata jetonin. Do të ishte e pandershme të vlerësonim trashëgiminë judeo-kristiane pa i kushtuar asnjë vëmendje kontekstit historik përkatës. Ç'është e vërteta, një i kuptuar i drejtë i kontekstit historik judeo-kristian është gjithashtu vendimtar për të kuptuarit e domethënies së kontributit të Islamit ndaj historisë dhe qytetërimit njerëzor. Tradita judeo-kristiane është ndikuar dhe trajtësuar nga rrethanat, kushtet dhe kulturat në të cilat ka ekzistuar. Aty nga shekulli i VII pas Krishtit, ky ndikim kishte shtrembëruar mesazhin origjinal hyjnor shpallur Moisiut dhe Jezusit (a.s), deri sa të mos njihej më. Statusi i varfër i grave në botën judeo-kristiane nga shekulli i shtatë është vetëm një rast në

çështjen që po diskutojmë. Prandaj, kishte një nevojë të madhe për një mesazh të ri hyjnor që do e kthente njerëzimin përsëri në rrugë të mbarë. Kur'ani e përshkroi misionin e të Dërguarit të ri si një çlirim për çifutët dhe të krishterët nga barrat e rënda që kishin qenë mbi ta:

“(Ata) që pranojnë (pasojnë) të Dërguarin, Profetin e paarsimuar (që nuk shkruan e as lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar në shkrimet (e shenjata) të vetë atyre - në Teurat dhe Ungjill - e që i urdhëron ata për çdo të mirë e i ndalon nga çdo e keqe; lejon ushqimet e këndshme dhe ua ndalon të pakëndshmet e i liron ata nga barra e rëndë e tyre dhe prangat që ishin mbi ta.” (7:157)

Prandaj Islami nuk duhet vështruar si një traditë rivale ndaj Judaizmit apo Krishterimit. Ai duhet konsideruar si përsosja, përfundimi dhe përkryerja e mesazheve hyjnore që ishin shpallur para tij.

Në fund të këtij studimi, do të doja t'i ofroja këshillën e mëposhtme bashkësisë globale muslimane. Aq shumë grave muslimane u janë mohuar të drejtat themelore islame për kaq gjatë. Gabimet e së kaluarës duhen ndrequr. Kryerja e kësaj nuk është një shërbesë, ajo është një detyrë që i ngarkohet të gjithë muslimanëve. Bashkësia mbarëbotërore muslimane prej 1.5 miliardë besimtarësh duhet të nxjerrë një kartë të të drejtave të bazuar në udhëzimet e qarta të Kur'anit dhe mësimet e Profetit të Islamit (s). Kjo kartë duhet t'u japë grave muslimane të gjitha të drejtat dhuruar atyre nga Krijuesi i tyre. Atëherë, të gjitha mjetet e nevojshme duhet të zhvillohen me qëllim që të sigurojë zbatimin e duhur të kartës. Kjo kartë është një borxh i lënë pas dore, por më mirë vonë se kurrë. Nëse muslimanët nëpër botë nuk do i garantojnë të drejtat e plota të nënave, grave, motrave dhe bijave të tyre, kush tjetër do e bëjë këtë atëherë?

Për më tepër, ne duhet të kemi kurajon të përballojmë të kaluarën tonë dhe të flakim traditat dhe zakonet e stërgjyshërve tanë kurdo që këto i kundërvihen udhëzimeve të Islamit. A nuk i kritikoi Kur'ani rreptësisht arabët paganë për të ndjekurit e verbër të traditave të paraardhësve të tyre? Nga ana tjetër, ne duhet të zhvillojmë një qëndrim kritik ndaj çfarëdogjëje që marrim nga Perëndimi, apo nga cilado kulturë tjetër. Bashkëveprimi me dhe të mësuarit nga kulturat e tjera është një përvojë e paçmueshme. Kur'ani e ka konsideruar në mënyrë të përmbledhur këtë bashkëveprim si një nga qëllimet e Krijimit: **“O njerëz, Ne ju krijuam nga një çift mashkulli dhe femre, dhe ju bëmë në popuj e fise që të njiheni mes njëri-tjetrit.” (49:13)** S'ka nevojë të thuhet, megjithatë, se një imitim i verbër i të tjerëve është një shenjë e sigurt e një mungese të skajshme të vetë-vlerësimit.

Është lexuesi jo-musliman, çifut, kristian apo tjetër, ai të cilit i drejtohen këto fjalë të fundit. Është e habitshme përse feja që ka revolucionarizuar statusin e grave veçohet dhe abuzohet me fyerje të rënda si më shtypësja e grave. Ky përndijim për Islamin është një nga mitet më të shumëpërhapura në botën tonë sot. Ky mit po përjetësohet nga një barazh i pareshtur librash, artikujsh, pamjesh mediatike dhe filmash hollivudianë sensacionalë. Rrjedhimi i pashmangshëm i këtyre pamjeve të pareshtura ngatërruese ka qenë keqkuptimi total dhe

frika prej çdo gjëje të lidhur me Islamin. Ky portretizim negativ i Islamit në mediat botërore duhet të marrë fund, nëse duam të jetojmë në një botë të liruar nga të gjitha gjurmët e diskriminimit, paragjykitimit dhe keqkuptimit. Jo-muslimanët duhet të kuptojnë ekzistencën e një hendeku të gjerë ndërmjet besimeve dhe praktikave të muslimanëve dhe faktin e thjeshtë se veprimet e muslimanëve nuk përfaqësojnë medoemos Islamin. T'i mvëshësh statusit të grave në botën muslimane emrin 'islamik' është aq larg nga e vërteta sa të quajturit e pozicionit të grave në Perëndim sot – "judeo-kristian". Me këtë të kuptuar në mendje, muslimanët dhe jo-muslimanët duhet të fillojnë një proces komunikimi dhe dialogu për të hequr tutje të gjitha keqkuptimet, dyshimet dhe frikërat. Një e ardhme e paqtë për familjen njerëzore e bën të nevojshëm një dialog të tillë.

Islami duhet të shikohet si një fe që përmirësoi jashtëzakonisht statusin e grave dhe u dhuroi e garantoj atyre shumë të drejta që në botën moderne o njohën vetëm në këtë shekull. Islami ka ende shumë për t'i ofruar gruas së sotme: dinjitetin, respektin dhe mbrojtjen në të gjitha aspektet dhe etapat e jetës së saj që nga lindja gjer në vdekje, përkrah njohjes, ekuilibrit dhe mjeteve efikase për përmbushjen e të gjitha nevojave të saj të përsëritshme, intelektuale, fizike dhe emocionale. S'është çudi përse shumica e atyre që zgjedhin të bëhen muslimanë në një vend si Britania janë gra. Në Sh.B. kthimet e grave në Islam i kalojnë ato të burrave 4 herë me 1.⁸⁶ Islami ka aq shumë për t'i ofruar botës sonë që ndodhet në një nevojë të madhe për drejtëm dhe udhëheqje morale. Ambasadori Herman Eilts, në një raportim përpara Komitetit të Punëve të Jashtme të Shtëpisë së Përfaqësuesve në Kongresin e Shteteve të Bashkuara më 24 Qershor 1985, tha: "Bashkësia muslimane e globit sot është në pragun e një miliardi.* (*Sipas të dhënave të vitit 2000, sot ka 1.34 miliardë muslimanë, dhe ajo mbetet feja me rritje më të shpejtë në botë) Kjo është një figurë impresionuese. Por ajo që më impresionon njëllëj mua është se sot Islami është feja monoteiste me rritje më të shpejtë në botë. Kjo është diçka që duhet ta marrim parasysh. Ka diçka të drejtë në lidhje me Islamin. Ai po tërheq një numër të madh njerëzish." Po, diçka është e drejtë te Islami dhe është koha të shohim çfarë. Shpresoj se ky studim përbën një hap në këtë drejtim.

Shënime

1. *The Globe and Mail*, 4 Tetor 1994.
2. Leonard J. Swidler, *Women in Judaism: the Status of Women in Formative Judaism* (Metuchen, N.J: Scarecrow Press, 1976) fq 115.
3. Thena Kendath, "Memories of an Orthodox Youth" in Susannah Heschel, ed., *On being a Jewish Feminist* (New York: Schocken Books, 1983) fq 96-97.
4. Swidler, vep. cit., fq 80-81.
5. Rosemary R. Ruether, "Christianity", in Arvind Sharma, ed., *Women in World Religions* (Albany: State University of New York Press, 1987) fq 209.
6. Për të gjitha thëniet e Shenjtorëve të shquar, shih Karen Armstrong, *The Gospel According to Woman* (London: Elm Tree Books, 1986) fq 52-62. Shih gjithashtu Nancy van Vuuren, *The Subversion of Women as Practised by Churches, Witch Hunters, and Other Sexists* (Philadelphia: Westminster Press) fq 28-30.
7. Swidler, vep. cit., fq 140.
8. Denise L. Carmody, "Judaism", in Arvind Sharma, ed., vep. cit., fq 197.
9. Swidler, vep. cit., fq 137.
10. Po aty, fq 138.
11. Sally Priesand, *Judaism and the New Woman* (New York: Behrman House, Inc., 1975) fq 24.
12. Swidler, vep. cit., fq 115.
13. Lesley Hazleton, *Izraeli Women: The Reality Behind the Myths* (New York: Simon and Schuster, 1977) fq 41.
14. Gage, vep. cit. (shih shën. 18), fq 142.
15. Jeffrey H. Togay, "Adultery", *Encyclopaedia Judaica*, Vëll. II, kol. 313. Gjithashtu, shih Judith Plaskow, *Standing Again at Sinai: Judaism from a Feminist Perspective* (New York: Harper & Row Publishers, 1990) fq 170-177.
16. Hazleton, vep. cit., fq 41-42.
17. Swidler, vep. cit., fq 141.
18. Matilda J. Gage, *Woman, Church, and State* (New York: Truth Seeker Company, 1893) fq 141.
19. Louis M. Epstein, *The Jewish Marriage Contract* (New York: Arno Press, 1973) fq 149.
20. Swidler, vep. cit., fq 142.
21. Epstein, vep. cit., fq 164-165.
22. Po aty, fq 112-113. Shih gjithashtu Priesand, vep. cit., fq 15.
23. James A. Brundage, *Law, Sex, and Christian Society in Medieval Europe* (Chicago: University of Chicago Press, 1987) fq 88.
24. Po aty, fq 480.
25. R. Thompson, *Women in Stuart England and America* (London: Routledge & Kegan Paul, 1974) fq 162.
26. Mary Murray, *The Law of the Father* (London: Routledge, 1995) fq 67.
27. Gage, vep. cit., fq 143.
28. Shih për shembull Jeffrey Lang, *Struggling to Surrender* (Beltsville, MD: Amana Publications, 1994) fq 167.
29. Elsayyed Sabiq, *Fiqh al-Sunnah* (Cairo: Dar al-Fatah lile'lam al-Arabi, bot. 11të, 1994) vëll. II, fq 218-229.
30. Abd al-Haleem Abu Shuqqa, *Tahrīral-Mar'aā fi Asr al-Risāla* (Kuwait: Dar al-Qalam, 1990) fq 109-112.

31. Leila Badawi, "Islam", in Jean Holm and John Bowker, ed., *Women in Religion* (London: Pinter Publishers, 1994) p. 102.
32. Amir H. Siddiqi, *Studies in Islamic History* (Karachi: Jamiyat al-Falah Publications, bot. 3, 1967) fq 138.
33. Epstein, vep. cit., fq 196.
34. Swidler, vep. cit., fq 162-163.
35. *The Toronto Star*, 8 Prill 1995.
36. Sabiq, vep. cit., fq 318-329. Shih gjithashtu Muhammad al-Ghazali, *Qadaya al-Mar'aā bin al-Taqalid al-Rakida wa'l-Wafida* (Cairo: Dar al-Shorooq, bot. 4t, 1992) fq 178-180.
37. Po aty, fq 313-318.
38. David W. Amram, *The Jewish Law of Divorce According to Bible and Talmud* (Philadelphia: Edward Stern & Co., Inc., 1896) fq 125-126.
39. Epstein, vep. cit., fq 219.
40. Po aty, fq 156-157.
41. Muhammad Abu Zahra, *Usbu al-Fiqh al-Islami* (Cairo: al-Majlis al-A'lā li Ri'ayāt al-Funūn, 1963) fq 66.
42. Epstein, vep. cit., fq 122.
43. Armstrong, vep. cit., fq 8.
44. Epstein, vep. cit., fq 175.
45. Po aty, fq 121.
46. Gage, vep. cit., fq 142.
47. B. Aisha Lemu and Fatima Heeren, *Woman in Islam* (London: Islamic Foundation, 1978) fq 23.
48. Hazleton, vep. cit., fq 45-46.
49. Po aty, fq 47.
50. Po aty, fq 49.
51. Swidler, vep. cit., fq 144-148.
52. Hazleton, vep. cit., fq 44-45.
53. Eugene Hillman, *Poligamy Reconsidered: African Plural Marriage and the Christian Churches* (New York: Orbis Books, 1975) fq 140.
54. Po aty, fq 17.
55. Po aty, fq 88-93.
56. Po aty, fq 92-97.
57. Philip L. Kilbride, *Plural Marriage For Our Times* (Westport, Connecticut: Bergin & Garvey, 1994) fq 108-109.
58. *The Weekly Review*, 1 Gusht 1987.
59. Kilbride, vep. cit., fq 126.
60. John d'Emilio and Estelle B. Freedman, *Intimate Matters: A History of Sexuality in America* (New York: Harper & Row Publishers, 1988) fq 87.
61. Ute Frevert, *Women in German History: from Bourgeois Emancipation to Sexual Liberation* (New York: Berg Publishers, 1988) fq 263-264.
62. Po aty, fq 257-258.
63. Sabiq, vep. cit., fq 191.
64. Hillman, vep. cit., fq 12.
65. Nathan Hare and Julie Hare, ed., *Crisis in Black Sexual Politics* (San Francisco: Black Think Tank, 1989) p. 25.
66. Po aty, fq 26.

67. Kilbride, vep. cit., fq 94.
 68. Po aty, fq 95.
 69. Po aty.
 70. Po aty, fq 95-99.
 71. Po aty, fq 118.
 72. Lang, vep. cit., fq 172.
 73. Kilbride, vep. cit., fq 72-73.
 74. Sabiq, vep. cit., fq 187-188.
 75. Abdul Rahman Doi, *Woman in Shari'ah* (London: Ta-Ha Publishers, 1994) fq 76.
 77. Po aty, fq 316-317. Gjithashtu shih Swidler, vep. cit., fq 121-123.
 78. Po aty, fq 139.
 79. Susan W. Schneider, *Jewish and Female* (New York: Simon & Schuster, 1984) fq 237.
 80. Po aty, fq 238-239.
 81. Alexandra Wright, "Judaism", in Holm and Bowker, ed., vep. cit., fq 128-129.
 82. Clara M. Henning, "Cannon Law and the Battle of the Sexes" in Rosemary R. Ruether, ed., *Religion and Sexism: Images of Woman in the Jewish and Christian Traditions* (New York: Simon & Schuster, 1974) fq 272.
 83. Donald B. Kraybill, *The Riddle of the Amish Culture* (Baltimore: John Hopkins University Press, 1989) fq 56.
 84. Raporti Vjetor i F.B.I., 1994.
 85. Khalil Gibran, *Thoughts and Meditations* (New York: Bantam Books, 1960) fq 28.
 86. *The Times*, 18 Nëntor 1993.
-

Shqipëroi: Edin Q. Lohja
Korrik 1996